



safejournalists.net

Shqipëria – Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve 2023

**Autor
Blerjana Bino**



TABELA E PËRMBAJTJES

| | | | |
|---|-----------|---|-----------|
| Rreth Projektit | 2 | C. Siguria e gazetarëve | 34 |
| Konteksti i treguesve | 2 | C.1 Gazetarët dhe punonjësit e medias kanë akses | |
| Shënime për metodologjinë | 3 | te masat e menjëhershme dhe efektive mbrojtëse | |
| Treguesit cilësorë për nivelin e lirisë së | 4 | kur ndjehen të kërcënuar | 34 |
| mediave dhe sigurisë së gazetarëve | 5 | C.2 Gazetarët dhe punonjësit e mediave (jeta ose | |
| Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve | 7 | integriteti fizik i të cilëve është në rrezik real dhe | |
| Lista e shkurtimeve | 7 | të menjëhershëm) kanë akses te mekanizma të | |
| | | posaçëm mbrojtjeje apo sigurie | 35 |
| I Hyrje | 8 | C.3 Gratë gazetare kanë akses te masat ligjore | |
| | | dhe mekanizma mbështetjeje kur përballen | |
| II Liria e medias dhe siguria e gazetarëve në | 11 | me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë | |
| Shqipëri – Treguesit | 11 | gjinore | 36 |
| A. Masat mbrojtëse ligjore dhe zbatimi i tyre | 11 | C.4 Praktika e rregullt e dënimit publikisht të | |
| A.1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe të | 11 | kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe | |
| gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë | 11 | mediave është krijuar | 37 |
| A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i autoritetit | 13 | C.5 Organet e policisë janë të ndjeshme ndaj | |
| rregullator | 13 | çështjes së mbrojtjes së gazetarëve | 39 |
| A.3 Pavarësia dhe autonomia e transmetuesve të | 14 | C.6 Njësitë/oficerët që mbulojnë hetimet e | |
| shërbimit publik | 14 | specializuara janë të pajisur me ekspertizën | |
| A.4 Mbështetja financiare për gazetari cilësore | 15 | përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj | |
| dhe përmbajtje të medias me interes publik | 15 | gazetarëve | 40 |
| A.5 Reklammat shtetërore në sektorin privat të | 16 | C.7 Hetimet për sulme të rënda fizike ndaj | |
| mediave | 16 | gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave | |
| A.6 Dispozitat ligjore për shpifjen dhe zbatimi e | 18 | kryhen në mënyrë efikase (të pavarur, të plotë dhe | |
| tyre nuk prodhojnë efekte frenuese për gazetarët | 18 | të menjëhershme) | 41 |
| dhe mediat | 18 | C.8 Gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave | |
| A.7 Ligjet e tjera zbatohen me objektivitet dhe u | 20 | mbrohen me efikasitetet nga format e ndryshme | |
| bëjnë të mundur gazetarëve dhe aktorëve të tjerë | 20 | të ngacmimeve online | 42 |
| të medias të punojnë lirisht dhe të sigurt | 20 | C.9 Hetimet e të gjitha formave të sulmeve dhe | |
| A.8 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve | 20 | dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të | |
| garantohet me ligj dhe respektohet nga | 20 | mediave kryhen në mënyrë transparente | 43 |
| autoritetet | 20 | C.10 Autoritetet shtetërore krijojnë sisteme | |
| A.9 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin | 21 | cilësore të mbledhjes së statistikave për t'i dhënë | |
| e tyre dhe të krijojnë, të anëtarësohen e të marrin | 21 | fund pandëshkueshmërisë | 43 |
| pjesë në shoqatat e tyre | 21 | C.11 Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike | 44 |
| A.10 E drejta për të aksesuar dokumente dhe | 23 | C.12 Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të | |
| informacione zyrtare | 23 | gazetarëve | 45 |
| B. Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve | 27 | C.13 Sulmet aktuale | 45 |
| B.1 Vendi i punës i gazetarëve është i garantuar | 27 | C.14 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe | |
| dhe i mbrojtur në mjedisin e punës | 27 | shoqatave të gazetarëve | 46 |
| B.2 Pavarësia editoriale në mediat private | 28 | | |
| B.3 Pavarësia editoriale e transmetuesve të | 29 | III Përfundime dhe rekomandime | 48 |
| shërbimit publik | 29 | | |
| B.4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jo- | 30 | IV Treguesi i sigurisë së gazetarëve në Shqipëri | 53 |
| fitimprurëse | 30 | – 2023 | |
| B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të | 31 | | |
| lajmeve | 31 | | |
| B.6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare | 32 | | |

Rreth Projektit

KONTEKSTI I TREGUESVE

Me mbështetjen e Komisionit Evropian¹, shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor kanë krijuar një platformë të përbashkët –[Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net)– për të monitoruar ndryshimet në legjislacionin dhe praktikën e vendeve të tyre dhe për t'u angazhuar në përmirësimin e mjedisit ligjor dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe mediat. Mbështetur në një metodologji² të hartuar me kujdes, partnerët e Safejournalists.net bëjnë çdo vit një hulumtim të advokimit, duke iu ofruar shoqatave të gazetarëve të dhëna të mbështetura në prova, që janë të besueshme dhe të dobishme për problemet dhe pengesat kryesore që hasen në zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirisë së mediave dhe sigurisë gazetarëve në Ballkanin Perëndimor. Gjetjet nga ky hulumtimi ndihmojnë në përmirësimin e aktiviteteve të partnerëve duke u ofruar atyre provat dhe shembujt më të fundit që përmirësojnë dhe forcojnë pozicionet e tyre advokuese.

Instrumenti i parë i hulumtimit cilësor, *Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve*, u hartua për herë të parë në vitin 2016 dhe u përmirësua gradualisht gjatë viteve në vazhdim. Ky instrument përbëhet nga tre grupe treguesish: (A) Mbrojtja ligjore; (B) Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve; dhe (C) Siguria e gazetarëve. Bazuar në këtë instrument monitorimi, janë botuar gjithsej shtatë vlerësime, më i fundit ai i vitit 2022.

1 Në dhjetor 2022, Komisioni Evropian miratoi një projekt të ri tre-vjeçar Safejournalists.net, i cili është në vazhdim të dy fazave të mëparshme: Projekti "Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Mbrojtjen e Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve (01.2016 - 12.2018) dhe Safejournalist.net (02.2020-03.2023). Qëllimi kryesor i projektit është fuqizimi dhe forcimi i shoqatave kombëtare të gazetarëve, anëtare të Platformës Safejournalists.net për t'u bërë aktorë të pavarur efektivë dhe të përgjegjshëm për mbrojtjen dhe hartimin e politikave të duhura për mediat në vendet e tyre: Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë (IJAS), Shoqata e Gazetarëve të BH (BHJ), Shoqata e Gazetarëve Kroatë (CJA), Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe Sindikata e Mediave të Mali i Zi (TUMM). Ky projekt financohet në kuadër të Programit për Shoqërinë Civile dhe Media në mbështetje të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë 2021-2023 (IPA III).

2 Ky hulumtim advokimi u hartua dhe koordinua Snezana Trpevska dhe Igor Micevski, bashkëpunëtorë shkencorë të Institutit Kërkimor për Zhvillimin Social RESIS nga Maqedonia e Veriut (www.resis.mk).

Në vitin 2020 u hartua një tjetër instrument hulumtimi sasior, *Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve*, instrument që u testua në vitin 2021. Ai u hartua për të 'matur' ndryshimet që ndodhin në sektorin e medias dhe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në nivelin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias gjatë ushtrimit të profesionit. Instrumenti përbëhet nga katër grupe treguesish: (1) Mjedisi ligjor dhe organizativ, (2) Parandalimi i duhur, (3) Procesi i rregullt dhe (4) Siguria aktuale. Nëpërmjet këtij instrumenti janë zbatuar gjithsej tre cikle hulumtimi: 2020 (viti pilot), 2021 dhe 2022.

Duke filluar që nga viti 2023, [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) do të ndërthurë të dy instrumentet e kërkimit (cilësor dhe sasior) në një projekt të vetëm hulumtimi për advokim, *Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve*. Platforma monitoron situatën në shtatë vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi, Kosovë³ dhe Serbi.

SHËNIME PËR METODOLOGJINË

I gjithë procesi i hulumtimi është i ndarë në dy faza: në fazën e parë mblidhen të dhëna për të gjithë treguesit cilësorë, si për liritë e medias ashtu edhe për sigurinë e gazetarëve. Në fazën e dytë, treguesit cilësorë për sigurinë e gazetarëve shndërrohen në tregues sasiorë, duke vijuar më tej me procesin e pikëzimit dhe llogaritjen e Treguesit (Indeksit) të Sigurisë së Gazetarëve.

Për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave janë zbatuar një sërë metodash të ndryshme kërkimore për secilin tregues specifik. Metodot kërkimore janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i studimeve, analizave, raporteve kërkimore, dokumenteve politike, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analiza cilësore e dokumenteve ligjore;
- Marrja dhe analizimi i informacionit të botuar në faqet zyrtare të institucioneve publike dhe organizatave dhe enteve të tjera;
- Marrja dhe analizimi i deklaratave për shtyp, njoftimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizatat profesionale;
- Të dhënat dytësore të mbledhura nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, politikëbërës, etj.;
- Diskutime në fokus grupe me gazetarë; dhe
- Sondazh me gazetarët (në disa vende).

³ Ky emër është pa paragjykim për statusin dhe në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin e Tribunalit për Shpalljen dhe Pavarësinë e Kosovës.

Në nivel shteti, hulumtimi i advokimit kryhet nga studiues kombëtarë që mbledhin të dhënat dhe hartojnë raportet përshkruese, të cilat më pas shqyrtohen nga ekspertë vendas për median dhe nga drejtuesi i hulumtimit. Në Shqipëri, drejtuesja e hulumtimit është Blerjana Bino, ndërsa Kristina Voko shërbeu si eksperte e medias dhe Erida Skëndaj si eksperte ligjore për shqyrtimin e raportit.

TREGUESIT CILËSORË PËR NIVELIN E LIRISË SË MEDIAVE DHE SIGURISË SË GAZETARËVE

Në tabelën e mëposhtme renditen të gjithë treguesit cilësorë për nivelin e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve, të ndarë në tre fusha. Këta tregues paraqiten në formë përshkruese ose narrative. Në këtë tabelë treguesit e përdorur në kuadrin konceptual për Treguesin (Indeksin) e Sigurisë së Gazetarëve janë shënuar me ngjyrë gri.

Tabela 1. Përmbledhje e të gjithë treguesve cilësorë (Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve)

| A. Masat mbrojtëse ligjore dhe zbatimi i tyre | B. Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve | C. Siguria e Gazetarëve |
|---|---|--|
| A.1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe të gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë | B.1 Vendi i punës i gazetarëve është i garantuar dhe i mbrojtur në mjedisin e punës | C.1 Gazetarët dhe punonjësit e medias kanë akses te masat e menjëhershme dhe efektive mbrojtëse |
| A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i autoritetit rregullator | B.2 Pavarësia editoriale në mediat private | C.2 Gazetarët dhe punonjësit e mediave kanë akses te mekanizma të posaçëm mbrojtjeje apo sigurie |
| A.3 Pavarësia dhe autonomia e transmetuesve të shërbimit publik | B.3 Pavarësia editoriale e transmetuesve të shërbimit publik | C.3 Gratë gazetare kanë akses te masat ligjore dhe mekanizma mbështetjeje |
| A.4 Mbështetja financiare për gazetari cilësorë dhe përmbajtje të medias me interes publik | B.4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jo-fitimprurëse | C.4 Praktika e rregullt e dënimit publikisht të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave |
| A.5 Reklammat shtetërore në sektorin privat të mediave | B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve | C.5 Organet e policisë janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve |
| A.6 Dispozitat ligjore për lidhje me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk prodhojnë efekte frenuese për gazetarët dhe mediat | B.6 Pozicioni ekonomik i gazetarëve (grave) | C.6 Njësitë/oficerët që mbulojnë hetimet e specializuara janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve |
| A.7 Ligjet e tjera zbatohen me objektivitet dhe u bëjnë të mundur gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias të punojnë lirisht dhe të sigurt | | C.7 Hetimet për sulme të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë efikase |
| A.8 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve garantohet me ligj dhe respektohet nga autoritetet | | C.8 Gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave mbrohen me efikasitetet nga format e ndryshme të ngacmimeve online |
| A.9 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, të anëtarësohen e të marrin pjesë në shoqatat e tyre | | C.9 Hetimet e të gjitha formave të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente |
| A.10 E drejta për të aksesuar dokumente dhe informacione zyrtare | | C.10 Autoritetet shtetërore krijojnë sisteme cilësore të mbledhjes së statistikave për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë |
| | | C.11 Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike |
| | | C.12 Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve |
| | | C.13 Sulmet aktuale |
| | | C.14 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve |

TREGUESI I SIGURISË SË GAZETARËVE

Sipas standardeve dhe rekomandimeve të Këshillit të Evropës dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, koncepti i "sigurisë së gazetarëve"⁴ operacionalizohet duke marrë parasysh katër dimensionet e mëposhtme:

- I. **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave mbrojtëse ligjore të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve;
- II. **Parandalimi i duhur** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekte të drejtpërdrejta në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve;
- III. **Procesi i rregullt** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe zyrtarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve;
- IV. **Siguria aktuale** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe mediave.

Në tabelën e mëposhtme përshkruhen katër dimensionet dhe treguesit që formojnë modelin teorik të konceptit të "sigurisë së gazetarëve". Gjatë fazës së parë të hulumtimit u mblodhën të dhëna për të gjithë këta tregues. Në fazën e dytë, bazuar në këto dëshmi të mbledhura, të nëntë anëtarët e Komisionit Këshillimor nga secili shtet vlerësuan situatën dhe caktuan pikë për secilin nga 19 treguesit.

Tabela 2. Përmbledhje e treguesve lidhur me Treguesin e Sigurisë së Gazetarëve

| I. Mjedisi ligjor dhe organizativ | II. Parandalimi i duhur | III. Procesi i rregullt | IV. Siguria aktuale |
|---|--|--|---|
| 1.1 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi e tyre nuk prodhojnë efekte frenuese për gazetarët dhe mediat | 2.1 Gazetarët dhe punonjësit e medias kanë akses te masat e menjëhershme dhe efektive mbrojtëse | 3.1 Njësitë/oficerët që mbulojnë hetimet e specializuara janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve | 4.1 Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike |
| 1.2 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve garantohet me ligj dhe respektohet nga autoritetet | 2.2 Gazetarët dhe punonjësit e mediave kanë akses te mekanizma të posaçëm mbrojtjeje apo sigurie | 3.2 Hetimet për sulme të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë efikase | 4.2 Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve |
| 1.3 Ligjet e tjera zbatohen me objektivitet dhe u bëjnë të mundur gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias të punojnë lirisht dhe të sigurt | 2.3 Gratë gazetare kanë akses te masat ligjore dhe mekanizma mbështetjeje | 3.3 Gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave mbrohen me efikasitetet nga format e ndryshme të ngacmimeve online | 4.3 Sulmet aktuale |

4 Hulumtuesit nga Instituti RESIS (www.resis.mk), Snežana Trpevska, Igor Micevski dhe Ljubinka Popovska Toševa hartuan [kuadrin konceptual dhe metodologjik](#) për Treguesin dhe modelin për agregimin, ponderimin dhe llogaritjen e tij.

| I. Mjedisi ligjor dhe organizativ | II. Parandalimi i duhur | III. Procesi i rregullt | IV. Siguria aktuale |
|--|---|--|--|
| 1.4 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, të anëtarësohen e të marrin pjesë në shoqatat e tyre | 2.4 Praktika e rregullt e dënimit publikisht të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave | 3.4 Hetimet e të gjitha formave të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente | 4.4 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve |
| 1.5 Vendi i punës i gazetarëve është i garantuar dhe i mbrojtur në mjedisin e punës | 2.5 Organet e policisë janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve | 3.5 Autoritetet shtetërore krijojnë sisteme cilësore të mbledhjes së statistikave për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë | |

Shënim: Kur në këtë raport përdoret gjinia mashkullore, duhet pasur parasysh se i referohemi njëkohësisht individëve femra, meshkuj dhe të tjerë, por që është thjeshtuar si term për lehtësi në të lexuar.

— LISTA E SHKURTIMEVE

- AKEP – Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
- AMA – Autoriteti i Mediave Audiovizive
- AMI – Agjencia për Media dhe Informim
- ATSH – Agjencia Telegrafike Shqiptare
- BE – Bashkimi Evropian
- BIRN – Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative
- DDoS – Distributed Denial of Service
(mohim i shumëfishtë i shërbimit)
- GJEDNJ – Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- IPTV – Internet Protocol Television
(televizion me lidhje me internet)
- KE – Komisioni Evropian
- KLJG – Këshilli i Lartë Gjyqësor
- KLP – Këshilli i Lartë i Prokurorisë
- KNQ – Konferenca Ndërqeveritare BE-Shqipëri
- KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- ODIHR – Zyra për Institucionet Demokratike
dhe të Drejtat e Njeriut
- OECD – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
- OSCE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
- QSH – Qeveria shqiptare
- RTSH – Radio-Televizioni Shqiptar
- SCiDEV – Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim
- SPAK – Struktura e Posaçme kundër
Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Hyrje

Shqipëria është republikë parlamentare me parlament njëdhomësh dhe një kornizë kushtetuese të krijuar për të mbështetur qeverisjen demokratike. Gjithsesi, ajo vazhdon të përballlet me sfida të mëdha në përmbushjen e këtyre parimeve. Shqipëria ka një sistem zgjedhor proporcional dhe organizon zgjedhje përgjithësisht konkurruese, ndonëse këto të fundit shpesh dëmtohen nga parregullsitë elektorale, si blerja dhe manipulimi i votave. Popullsia në Shqipëri është e larmishme, përfshirë këtu pakicat e njohura kombëtare si grekët, maqedonasit, vllahët/arumunët, romët, egjiptianët, malazezët, bullgarët, boshnjakët dhe serbët.⁵ Kultura politike në Shqipëri karakterizohet nga polarizimi i tejskajshëm, dominimi i klientelizmit, korrupsioni i përhapur dhe ndikimi i personazheve të fuqishme politike, të cilët shpesh minojnë proceset demokratike. Shqipëria klasifikohet si regjim tranzicioni ose hibrid⁶ dhe konsiderohet pjesërisht e lirë⁷ për sa i përket të drejtave politike dhe lirive civile.

Në vitin 2023, skena politike në Shqipëri karakterizohej nga një polarizim i theksuar, veçanërisht brenda Partisë Demokratike në opozitë, e cila vuante nga ndasitë e brendshme, duke dobësuar kështu aftësinë e saj për t'i kërkuar llogari qeverisë. Kjo paqëndrueshmëri kontribuoi në mosfunksionimin e Parlamentit, duke i dhënë mundësi Partisë Socialiste në pushtet, të udhëhequr nga kryeministri Edi Rama, të konsolidonte dominimin e saj me anë të një fitoreje vendimtare në zgjedhjet vendore të majit 2023.⁸ Këto zgjedhje u njollosën nga akuzat për shkelje të shumta zgjedhore, përfshirë këtu shitblerjen e votës dhe keqpërdorimi i burimeve publike,⁹ gjë që evidentonte shqetësimet për integritetin e demokracisë në vend. Edhe në mjedisin politik u

5 Ligji Nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", aksesuar më 10 maj 2024.

6 Freedom House. "Shqipëria: Kombet në tranzit 2024," aksesuar më 5 qershor 2024.

7 Freedom House. "Shqipëria: Liria në botë 2024," aksesuar më 5 qershor 2024.

8 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Rezultatet e zgjedhjeve vendore" aksesuar më 5 qershor 2024.

9 OSBE/ODIHR. "Republika e Shqipërisë, Zgjedhjet Vendore, 14 maj 2023: Raporti përfundimtar," aksesuar më 12 maj 2024.

evidentua një përkeqësim për hapësirën e shoqërisë civile¹⁰ dhe lirinë e medias, teksa gazetarët përballeshin me rritje të presionit dhe kërcënimeve. Raporti i Progresit i BE-së për vitin 2023 njohu përparimet e Shqipërisë në përafrimin me standardet e BE-së, veçanërisht në sundimin e ligjit dhe administratën publike, por theksoi nevojën për përpjekje të mëtejshme për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin.¹¹ Edhe Këshilli Evropian e njohu progresin e reformave në Shqipëri, duke parashikuar hapjen e negociatave për bazat,¹² ndonëse klima problematike politike vazhdon të ndikojë në lirinë dhe pavarësinë e gazetarëve, pasi organet e medias shpesh i nënshtrohen interesave politike për të shmangur ndëshkimet.

Në vitin 2023, ekonomia shqiptare u rrit me 3.3%, e nxitur nga rritja e konsumit, eksporteve dhe investimeve private, pavarësisht sfidave me rritjen e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve.¹³ Vendi u fokusua te reformat strukturore me qëllim rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës, me fokus të veçantë te turizmi, bujqësia dhe dixhitalizimi. Gjithsesi, këto zhvillime ekonomike nuk u përkthyen në përmirësime të kushteve të gazetarëve. Sektori i medias mbetet i dominuar nga disa konglomerate në pronësi familjare me ndikim të madh politik dhe ekonomik, gjë që mbyl pluralizmin dhe pavarësinë e mediave.¹⁴ Shoqëruar edhe nga presionet ekonomike, ky përqendrim i konsiderueshëm i pronësisë së mediave i detyron shumë gazetarë të pranojnë të punojnë në kushte të pasigurta pune, duke u përballur me kërcënime dhe shpesh të detyruar të veprojnë në përputhje me interesat e pronarëve të mediave dhe elitave politike.¹⁵ Si rezultat, mjedisi ekonomik nxit në mënyrë të tërthortë një atmosferë të vështirë për lirinë e shtypit, ku gazetarët përpiqen të raportojnë në mënyrë të pavarur dhe me objektivitet.

Në Shqipëri aktualisht funksionojnë katër transmetues kombëtarë televizivë, një transmetues publik dhe tre transmetues privatë. Transmetuesi publik ka 16 kanale televizive rajonale dhe tematike. Po ashtu, ekzistojnë edhe 37 kanale televizive lokale dhe 21 kanale kabllorë/ IPTV/OTT.¹⁶ Pavarësisht pranisë së rreth 130 mediave online¹⁷, vetëm një pjesë e vogël funksionojnë me modele të qëndrueshme biznesi me financim transparent.¹⁸ Sektori i medias së shkruar ka pësuar rënie, ku kanë mbetur vetëm tetë gazeta të përditshme, bashkë me një revistë të përjavshme biznesi dhe disa botime mujore.¹⁹ Aktualisht në Shqipëri transmetojnë 3 radio kombëtare private dhe 52 radio rajonale private. Transmetuesi publik ka 11 stacione radiofonike.²⁰ Në vitin 2023 Shqipëria kishte 922

10 Për më shumë informacion për zvogëlimin e hapësirës për shoqërinë civile në [përkujtimin e 33-vjetorit të udhëtimit demokratik dhe konferenca e dytë kombëtare për hapësirën e shoqërisë civile](#)

11 Komisioni Evropian. "Raporti për Shqipërinë 2023" aksesuar më 5 prill 2024.

12 Këshilli i Bashkimit Evropian. 2023. "Këshilli miraton konkluzionet e zgjerimit," aksesuar më 31 maj 2024.

13 Banka Botërore. 2024. "Shqipëria: Përmbledhje," aksesuar më 18 qershor 2024.

14 Monitori i Pronësisë së Mediave, Shqipëria. 2023. "Shqipëria: Përmbledhje e pronësisë së mediave," aksesuar më 13 korrik 2024.

15 Raporte nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt për Shqipërinë 2020, 2021, 2022

16 Monitori i Pronësisë së Mediave, Shqipëria. 2023. "Shqipëria: Përmbledhje e pronësisë së mediave," aksesuar më 13 korrik 2024.

17 Studimi i vitit 2024 nga Këshilli Shqiptar i Medias numëron në këtë shifër ato media online me të paktën 1 lajm origjinal. Ky studim hedh poshtë pretendimin se në Shqipëri ka 900 portale lajmesh.

18 Këshilli Shqiptar i Medias. 2024. "Harta e Mediave online në Shqipëri," aksesuar më 13 gusht 2024.

19 Monitori i Pronësisë së Mediave, Shqipëria. 2023. "Media e shkruar në Shqipëri: Përmbledhje," aksesuar më 13 gusht 2024.

20 Monitori i Pronësisë së Mediave, Shqipëria. 2023. "Radio në Shqipëri: Përmbledhje," aksesuar më 13 gusht 2024.

gazetarë, paga mesatare e të cilëve është 72,898 lekë në muaj.²¹ Mjedisi mediatik ndikohet shumë nga interesat politike dhe ekonomike, gjë që shpesh rezulton në raportim të njëanshëm dhe në kufizim të pavarësisë editoriale. Shqipëria u rendit e 99-ta nga 180 vende në Treguesin Botëror të Lirisë së Shtypit 2024 të hartuar nga organizata 'Reporterët pa Kufi'²², duke evidentuar kështu sfidat e vazhdueshme me të cilat përballet liria e mediave në vend. Kuadri rregullator ka pasur disa zhvillime, si amendamentet në Ligjin "Për Mediat Audiovizive", që synojnë përafrim më të mirë të ligjit me standardet e BE-së.²³ Megjithatë, problemet me politizimin e autoriteteve rregullatore të medias dhe me mbrojtjen e pamjaftueshme të gazetarëve vazhdojnë. Qeveria Shqiptare (QSH) është kritikuar se ushtron ndikim në përmbajtjen e raportimeve të mediave nëpërmjet subvencioneve dhe masave rregullatore, gjë që ndërlikon edhe më shumë në sektorin e mediave dhe minon lirinë e shtypit.

21 Të dhënat janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në janar të vitit 2024 pas një kërkesë për informacion. Kjo pagë mesatare është fare pak mbi pagën minimale kombëtare, e cila në vitin 2023 u vendos në nivelin 40,000 lekë në muaj. Për më tepër, sektori i medias në Shqipëri karakterizohet nga një nivel i lartë informaliteti, ku shumë profesionistë të medias, veçanërisht ata që punojnë në media online, nuk mund të regjistrohen apo deklarohen zyrtarisht. Përveç kësaj, është e zakonshme që gazetarët të marrin një pjesë të pagës në dorë, gjë që nuk pasqyrohet në statistikat zyrtare, duke e komplikuar më tej vlerësimin e të ardhurave të tyre reale. Këta faktorë kontribuojnë te kushtet e pasigurta të punës dhe kufizojnë stabilitetin financiar të gazetarëve, duke minuar aftësinë e tyre për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe me efektivitet në një peizazh mediatik sfidues që ndikohet shumë nga interesat politike dhe ekonomike.

22 Reporterët pa Kufi. 2024 "[Shqipëria: Treguesi i Lirisë së Shtypit](#)," aksesuar më 13 korrik 2024.

23 SCiDEV. 2024. "[Liria e mediave në Shqipëri: Raporti Hije 2024](#)," aksesuar më 13 gusht 2024.



Liria e medias dhe siguria e gazetarëve në Shqipëri – Treguesit

A. MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

— A.1 GARANCITË LIGJORE PËR LIRINË E MEDIAVE DHE TË GAZETARËVE DHE ZBATIMI I TYRE NË PRAKTIKË

Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe të drejtën e informimit.²⁴ Këto liri konsiderohen të drejta kushtetuese, por mund të kufizohen me ligj nëse i shërbejnë një interesi publik ose mbrojnë të drejtat e të tjerëve.²⁵ Kufizime të tilla duhet të jenë në raport me rrethanat që i bëjnë të nevojshme, nuk duhet të cenojnë thelbin e këtyre lirive dhe nuk duhet të kalojnë kufijtë e përcaktuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.²⁶ Megjithatë, në praktikë këto të drejta jo gjithmonë respektohen²⁷ dhe në Shqipëri evidentohen shkelje të ndryshme herë fshehtazi dhe herë haptazi të këtyre garancive kushtetuese në një sektor mediatik të dominuar nga ndërthurja e interesave të biznesit dhe politikës, burimeve të dyshimta financiare, përqendrimit të pronësisë së mediave dhe mungesës së transparencës, taktikave të kërcënimit dhe kushteve të pasigurta të punës.²⁸

Kuadri ligjor në fuqi që garanton lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit nuk trajton apo përcakton shprehimisht aksesin në internet.

24 Nenet 22 dhe 23 të [Kushtetutës së Shqipërisë](#). Neni 22 shprehet se liria e shprehjes është e garantuar. Neni 22/1 përcakton se liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar. Neni 23/1 përcakton se e drejta e informimit është e garantuar.

25 Neni 17/1 i [Kushtetutës së Shqipërisë](#)

26 Neni 17/2 [Kushtetutës së Shqipërisë](#).

27 Në [Raportin Vjetor të BE-së](#) theksohen sfidat e vazhdueshme që vijnë nga ndërthurja e interesave të biznesit dhe me ato të politikës, burimet e dyshimta financiare, përqendrimi i pronësisë së mediave, taktikat e kërcënimit dhe kushtet e pasigurta të punës. Të gjithë këta faktorë u bënë pengesë për pavarësinë e medias, pluralizmin dhe cilësinë e përgjithshme të gazetarisë në vend. Duke evidentuar problematika të ngjashme, në [Raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së për vitin 2023 mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut](#) nënvizohet se si aktorë të ndryshëm, përfshirë këtu institucionet shtetërore, partitë politike, bizneset dhe organizatat kriminale, tentuan të ushtronin ndikim të padrejtë tek mediat me mjete të papërshtatshme dhe jotransparente. [Raporti "Kombet në Tranzit" i Freedom House](#) për vitin 2023 paraqet për Shqipërinë një pamje të zymtë të hapësirës së shoqërisë civile dhe mjedisit mediatik në vend, duke e karakterizuar atë si të përkeqësuar. Siç theksohet në raport, një erozion i tillë komprometon seriozisht angazhimin demokratik të Shqipërisë. Për më tepër, në [Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit](#) Shqipëri ra me tre vende për vitin 2023, duke e çuar atë në kategorinë e vështirë të Zonës 4, nga gjithsej 5 zona, ku kjo e fundit përfaqëson regjimet më shtypëse. Kjo rënie nënkupton një prirje shqetësuese drejt rritjes së kufizimeve në lirinë e shtypit dhe pavarësinë e medias në vend. Në Vlerësimin e Reporterëve pa Kufij (RSF) për vitin 2023 nxirreshin në pah si kërcënimet kryesore për lirinë e shtypit dhe autonominë e mediave në Shqipëri këto tendenca, duke identifikuar konfliktet e interesit mes bizneseve dhe partive politike, mangësitë në kuadrin ligjor dhe praktikën rregullatore të njëanshme.

28 SCIDEV. 2024. ["Liria e mediave në Shqipëri: Raporti Hije 2024,"](#) aksesuar më 13 prill 2024.

Megjithatë, në Shqipëri, aksesit në internet mbështetet në standardet e përcaktuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.²⁹ Për vitin 2023, nuk pati raportime të rasteve ku qeveria të ketë kufizuar apo ndërprerë aksesin në internet apo të ketë censuruar përmbajtje në internet. Po ashtu, nuk ka pasur raportime as për raste ku qeveria të ketë monitoruar komunikimet private online pa autorizimin përkatës ligjor.³⁰ Në arsyet kryesore për kufizimet e mundshme të lirisë së shprehjes në internet të rregulluara nga legjislacioni shqiptar përfshihen shpifja, gjuha e urrejtjes, materialet me të drejta autori dhe mbrojtja e të dhënave dhe detyrimi i gazetarëve nga gjykata për të treguar burimin e informacionit në proceset penale.

Për sa i përket legjislacionit për median, në shtator 2022, qeveria shqiptare ndërmori një proces konsultimi publik për një propozim që lidhet me një ndryshim në Ligjin Nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".³¹ Ky amendament kishte si qëllim të përfronte legjislacionin shqiptar me dispozitat e përshkruara në Direktivën (BE) 2018/1808.³² Projektligji u miratua në Kuvend në prill të vitit 2023. Është për t'u evidentuar se organizatat e shoqërisë civile vlerësuan përfshirjen e një përkufizimi gjithëpërfshirës të seksizmit në përmbajtjen mediatike.³³ Për më tepër, në vitin 2023, Autoriteti i Mediave Audiovizive miratoi Kodin e rishikuar të Transmetimit Audioviziv.³⁴ Ky kod i përditësuar përcakton parimet themelore, rregulloret, parakushtet dhe standardet operative që rregullojnë transmetimet audio dhe audiovizive.³⁵ Po ashtu, në dhjetor 2023 AMA propozoi sërish ndryshime në Ligjin Nr. 97/2013, ndryshime që janë ende në fazat e hershme të propozimit dhe konsultimit me palët e interesuara, duke u fokusuar në tre fusha kryesore: matja e audiencës, ripërcaktimi i licencimit për mbajtësit e mediave rajonale dhe lokale, dhe trajtimi i shkeljeve të të drejtave të transmetimit për tregun audioviziv.³⁶ Ndryshimet e shpeshta të paraqitura nga AMA gjatë gjithë vitit ia bëjnë të vështirë shoqërisë civile të mbajë ritmin dhe të angazhohet plotësisht në procesin e konsultimit, duke ndikuar potencialisht në qëndrueshmërinë dhe parashikueshmërinë e mjedisit rregullator për mediat audiovizive. Pas raportit të vlerësimit të Komisionit Evropian, në tetor 2023, qeveria shqiptare nisi një proces konsultimi për Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës

-
- 29 GJEDNJ. 2022. Fishë informuese "[Aksesi në internet dhe liri për të marrë dhe për të dhënë informacion dhe ide](#)," aksesuar më 13 prill 2024.
- 30 Në [Raportin Vjetor të Shkeljeve të të Drejtave Dixhitale 2022-2023](#) të BIRN raportohen 156 shkelje të të dhënave dhe programeve, gjuha e urrejtjes në internet dhe diskriminim. Gjetja e autorëve të këtyre rasteve është mjaft e vështirë, duke pasur parasysh se në 55 autorët janë të panjohur, 43 raste lidhen me mediat online dhe 35 me qytetarë.
- 31 Ligji Nr. 30/2023 "[Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 97/2013, Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë](#) ", të ndryshuar, aksesuar më 13 maj 2024.
- 32 Procesi i konsultimit publik për amendamentin e propozuar të Ligjit Nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", filloi në shtator 2022 dhe u realizua nëpërmjet një portali konsultimi publik online. Projektligji mbeti i hapur për shqyrtim dhe komente nga publiku për një periudhë prej 30 ditësh. Sipas raportit të konsultimit, pjesëmarrja nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) ishte e kufizuar, ku vetëm dy OSHC dërguan komente me shkrim përmes portalit online. Për më tepër, tre operatorë mediash zgjodhën t'i dërgojnë komentet e tyre drejtpërsëdrejti tek Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Veçanërisht, procesi i konsultimit përfshiu edhe angazhimin me Drejtoritë e Përgjithshme të Komisionit Evropian, përfshirë DG Near dhe DG Connect, si dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian. Ky angazhim synonte të siguronte përfrimin me direktivat dhe standardet e Bashkimit Evropian. Më pas, u publikua një raport gjithëpërfshirës që detajonte rezultatet e procesit të konsultimit.
- 33 Citizens Channel. "[Ndryshon Ligji për Mediat Audiovizive: Nga Sot Shtohet Përkufizimi për Seksizmin](#)" aksesuar më 23 maj 2024.
- 34 Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). "[AMA Miraton Kodin e Ri të Transmetimit](#)" aksesuar më 23 maj 2024.
- 35 Në procesin e hartimit të këtij kodi u bënë konsultime me grupet e shoqërisë civile dhe organet e medias. Qëllimi kryesor i kodit të rishikuar është përmirësimi i zbatimit të parimeve të barazisë gjinore dhe lufta kundër gjuhës së urrejtjes dhe shpërndarjes së disinformimit në sektorin e mediave audiovizive.
- 36 Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). 2023. "[Propozimet për Ndryshime në Ligjin për Median Audiovizive: AMA Zhvillon Tryezën e Parë të Konsultimit me Grupet e Interesit](#)," aksesuar më 23 maj 2024.

– Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” me masa të posaçme për sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e medias.³⁷

Institucionet publike nuk kanë zbatuar kriteret e licencimit apo kërkesa të rrepta për krijimin e mediave të shkruara dhe online. Aktualisht, nuk ka asnjë kërkesë që media e shkruar dhe ajo online të aplikojnë për licenca, përveç regjistrimit të zakonshme të biznesit dhe tek drejtorja e taksave. Portalet e mediave online duhet të regjistrojnë domenet e tyre tek Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)³⁸ dhe të japin informacionin bazë për pronarët dhe kontaktet. Po ashtu, nëse këto portale nxjerrin të ardhura nëpërmjet reklamave ose abonimeve ose mjeteve të tjera, ato duhet të regjistrohen në organet tatimore. Shqipëria nuk mban një regjistër publik të pronësisë së medias. Informacioni për pronësinë e medias mund të gjendet në Qendrën Kombëtare të Biznesit/Regjistrin të Pronarëve Përfitues.³⁹ Duke qenë se mediat mund të jenë në pronësi të kompanive që mbulojnë sektorë të ndryshëm, është e vështirë të identifikohen pronarët e mediave në Regjistrin Kombëtar të Bizneseve pa një regjistër publik të pronarëve të mediave ose listë pronarësh (Impressum) në faqet zyrtare të mediave. Organizatat mediatike jofitimprurëse duhet të regjistrohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ligji 112/2022 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues” vlen edhe për organizatat jofitimprurëse. Ashtu si në vitet e mëparshme, ende nuk është hartuar një përkufizim ligjor për mediat online.

— A.2 PAVARËSIA DHE EFIKASITETI I AUTORITETIT RREGULLATOR

Kandidatët për në Bordin e AMA-s propozohen nga aktorë të ndryshëm, përfshirë shoqërinë civile, por procesi i përzgjedhjes lë hapësirë për një ndikim të madh të politikës. Ligji 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”,⁴⁰ i jep të drejtën opozitës dhe partisë në pushtet të vënë veton ndaj kandidatëve të propozuar nga grupet e shoqërisë civile në Komisionin Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Paanshmëria e disa anëtarëve të Bordit të AMA-s është vënë në pikëpyetje për shkak të përkatësive të tyre politike. Po ashtu, kuadri ligjor për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të AMA-s nuk siguron efektivisht pavarësinë e tyre, duke qenë se katër anëtarë zgjidhen me mbështetjen e shumicës parlamentare dhe tre janë propozime të opozitës.

Edhe në vitin 2023, vazhduan shqetësimet lidhur me pavarësinë dhe funksionimin e AMA-s, institucionit rregullator që mbikëqyr transmetimet audiovizive. Kryetarja e AMA-s, Armela Krasniqi,

37 Gjatë periudhës 30-ditore të konsultimit në tetor 2023, vetëm tre organizata dhanë [komente](#), siç evidentohet në raportin e konsultimit. Nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë organizoi tre takime të platformës së partneritetit për integrimin evropian për të diskutuar draft udhërrëfyesin. Rrjeti SafeJournalists (Gazetarë të Sigurt) kontribuoi me sugjerime përmes një [letre të hapur](#), ndërsa grupet e shoqërisë civile shprehën shqetësimet e tyre për mungesën e një konsultimi të plotë dhe gjithëpërfshirës për udhërrëfyesin. Këto shqetësime burojnë nga perceptimet për plotësinë dhe gjithëpërfshirjen e kufizuar të procesit. Versioni përfundimtar i udhërrëfyesit nuk është publikuar ende në internet (që nga qershori 2024). Nuk është gati as versioni anglisht i tij. Kështu, mungesa e transparencës dhe aksesueshmërisë i rrit edhe më shumë shqetësimet për gjithëpërfshirjen.

38 Drejtori i Përgjithshëm i AKEP-it është [ish-këshilltar](#) i kryeministrit Rama, duke ngritur kështu pikëpyetje për pavarësinë e institucionit.

39 Ligji Nr. 112/2022, “[Për regjistrin e pronarëve përfitues](#)”

40 Zgjedhja e anëtarëve dhe e kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në Shqipëri rregullohet me dispozita të veçanta në [ligj](#). Kandidatët për në Bordin e AMA-s propozohen nga aktorë të ndryshëm, përfshirë shoqërinë civile, por procesi i përzgjedhjes lë hapësirë për një ndikim të madh të politikës. Pas një liste paraprake, përfaqësuesit si nga shumica parlamentare ashtu edhe nga opozita mund t'i vënë veton kandidatëve, duke u dhënë kështu mundësinë partive politike të bllokojnë emrat e propozuar nga shoqëria civile. Ky proces përshkruhet me hollësi në nenet 9 dhe 10 të ligjit për AMA-n.

u emërua në këtë pozicion në korrik 2021. Ajo është e lidhur politikisht me partinë në pushtet, gjë që ka ngritur shqetësime lidhur me paanshmërinë e saj. Lidhjet e ngushta të Krasniqit me kryeministrin Rama dhe Partinë Socialiste, së bashku me rolet e saj të mëparshme si zëdhënëse e partisë dhe drejtuese e Agjencisë Telegrafike Shqiptare, institucion publik, kanë nxitur më tej dyshimet për autonominë e saj. Gjithashtu, në shkurt 2022, Kuvendi i ri plotësoi gjashtë vende vakante në Këshillin Drejtues të AMA-s në përputhje me Ligjin për Median, duke i dhënë të drejtën si opozitës ashtu edhe partisë në pushtet të vënë veton ndaj kandidatëve të propozuar nga organizatat e shoqërisë civile. Lidhjet politike të disa anëtarëve të AMA-s kanë ngritur shqetësime për sa i përket paanshmërisë së autoritetit, duke vënë në dyshim aftësinë e tyre për të vepruar në mënyrë të pavarur. Për më tepër, deklaratat e tyre publike kanë shfaqur një rreshtim të dukshëm politik, duke shtuar kompleksitetin e perceptimeve për neutralitetin e AMA-s.⁴¹

Në Shqipëri, AMA është përgjegjëse për rregullimin e veprimtarive të transmetimit, përfshirë dhënien dhe heqjen e licencave për shërbimet televizive dhe radiofonike. Efektiviteti dhe paanshmëria e këtij institucioni në monitorimin e respektimit të detyrimeve të licencimit janë bërë subjekt shqyrtimi.⁴² Kriteret për rinovimin e licencave zakonisht kanë të bëjnë me vlerësimin nëse transmetuesit përmbushin detyrimet ligjore dhe teknike, ndonëse specifikat mund të jenë të paqarta dhe të ndikuara nga interesat politike dhe ekonomike.⁴³ Aktualisht licencimi nuk është shqetësim i madh në Shqipëri, pasi shumica e frekuencave të transmetimit janë përcaktuar tashmë dhe kalimi të transmetimit dixhitale ka përfunduar.

— A.3 PAVARËSIA DHE AUTONOMIA E TRANSMETUESVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

Ndonëse autonomia dhe pavarësia e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) si transmetues publik janë teorikisht (ligjorisht) të garantuara, janë shfaqur vështirësi në praktikë. Në qershor 2023, Këshilli Drejtues zgjodhi njëzëri Drejtorin e ri të Përgjithshëm. Megjithatë, emërimi i fundit i z. Alfred Peza në këtë detyrë ka ngjallur shqetësime të mëdha, që rrjedhin nga angazhimi i konsiderueshëm politik i z. Peza, përfshirë këtu periudhën si deputet i Partisë Socialiste nga viti 2013 deri në 2017 dhe si Sekretar i Marrëdhënieve me Shoqërinë Civile dhe Median pranë Partisë Socialiste deri në shtator 2021.⁴⁴ Kundërshtim ndaj këtij emërimi është shprehur edhe nga aktorë të tjerë.⁴⁵

RTSH ka pavarësi financiare të krijuar nëpërmjet burimit kryesor të financimit nga fondet publike, që mbledhen nëpërmjet një zëri të veçantë në faturën e energjisë elektrike për konsumatorët

41 Për më shumë shih [Letër shqetësimi nga Rrjeti Safe Journalists](#).

42 Për shembull, në vitin 2023, AMA i hoqi licencën platformës televizive TIBO për shkak të shkeljeve të përsëritura që lidhen me transmetimin pirat të programeve televizive, përfshirë këtu aktivitete sportive dhe prodhime të tjera. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata Administrative e Tiranës, e cila rrëzoi përpjekjen e TIBO-s për të kundërshtuar heqjen e licencës.

43 Komisioni i Venecias. "[Projektligji i rishikuar për shërbimet mediatike audiovizive në Shqipëri](#)" aksesuar më 23 maj 2024.

44 Rrjeti SafeJournalists. "[Letër Shqetësimi i Rrjetit SafeJournalists për Zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH](#)" aksesuar më 23 maj 2024.

45 BalkanWeb. "[Zgjedhja e Alfred Pezës në Krye të RTSH, Deputetja Ina Zhupa: Antiligjore, Shkel 4 Kushte të Ligjit dhe Është Kapje Politike](#)" aksesuar më 23 maj 2024.

familjarë, po ka ende vështirësi lidhur me transparencën dhe menaxhimin e këtyre fondeve.⁴⁶ Në vitin 2021, ish-Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së dhe tre anëtarë të komisionit u arrestuan për shkelje të rregullave të prokurimit. Më pas, në qershor 2022, ish-Drejtori i Përgjithshëm u dënua me dy vjet burg dhe pesë vjet ndalim për ushtrimin e funksioneve publike. Administrimi i fondeve nga RTSH iu nënshtrua një kontrolli të mëtejshëm në vitin 2023, kur ky institucion nuk publikoi menjëherë në internet vendimet e Këshillit Drejtues dhe neglizhoi të trajtonte shqetësimet e ngritura nga palët e interesuara lidhur me shkarkimet e supozuara të paligjshme të stafit. Po ashtu, të paktën deri në maj 2024 nuk është publikuar ende raporti vjetor për vitin 2023, duke rritur edhe më shumë shqetësimet për transparencën dhe llogaridhënien në këtë institucion. Raporti për vitin 2022 është publikuar vetëm në faqen zyrtare të Kuvendit dhe nuk është në përputhje me kërkesat e të dhënave të hapura dhe aksesueshmërisë.⁴⁷

Organi mbikëqyrës i RTSH, i njohur si KDRTSH (Këshilli Drejtues), është përballur me kritika për përfaqësimin dhe paanshmërinë e tij. Anëtarët e KDRTSH-së zgjidhen nga Kuvendi, ndërsa në vitin 2021 ka pasur raste kur partitë kryesore të opozitës nuk kanë qenë të pranishme në këto zgjedhje, duke ngritur shqetësime për diversitetin dhe përfaqësimin e këtij organi. Përsa i përket angazhimit me shoqërinë civile, nuk ka konsultime të rregullta e të strukturuar ndërmjet KDRTSH-së dhe organizatave të shoqërisë civile për çështje programore apo për çështje të tjera të RTSH-së. Raporti Vjetor 2022 nuk ka asnjë informacion për angazhimin me shoqërinë civile.⁴⁸

— A.4 MBËSHTETJA FINANCIARE PËR GAZETARI CILËSORE DHE PËRMBAJTJE TË MEDIAS ME INTERES PUBLIK

Nuk ka subvencione të drejtpërdrejta për sektorin e medias së shkruar në Shqipëri dhe procesi i dhënies së çdo forme mbështetjeje financiare, si reklamat shtetërore, shpesh kritikohet për mungesë transparence dhe ndershmërie. Aktualisht, Shqipëria nuk ka një fond të posaçëm të dedikuar për nxitjen e prodhimit të përmbajtjes mediatike me interes publik që të përfshijë çështje më të gjera përtej atyre që trajtohen nga transmetuesi publik RTSH, i cili ka detyrimin ligjor të prodhojë programe të pakicave duke përdorur fondet e mbledhura nga taksat ose nga buxheti i shtetit. Sektori i mediave në Shqipëri ndikohet ndjeshëm nga interesat e biznesit dhe politikës, gjë që ndikon në diversitetin dhe pavarësinë e përmbajtjes së prodhuar nga këto media. Kjo situatë përkeqësohet nga mungesa e një fondi ose instrumenti të posaçëm financiar për të mbështetur pluralizmin dhe pavarësinë e mediave, duke bërë që shumë media të mbështeten më shumë për krijimin e të ardhurave nga reklamat dhe, ndonjëherë, nga kontratat qeveritare që lidhen me bizneset e pronarëve, gjë që mund të rrezikojë pavarësinë editoriale. Prosesi i ndarjes së fondeve dhe burimeve brenda

46 Shih statusin e RTSh-së Neni 2, pikat 1 dhe 2

47 RTSH. "Raporti i Veprimtarisë 2022" aksesuar më 23 maj 2024.

48 Rrjeti SafeJournalists. "Treguesit mbi Nivelin e Lirive të Mediave dhe Sigurinë e Gazetarëve në Shqipëri 2022" aksesuar më 23 maj 2024.

sektorit të medias shpesh është i politizuar. Disa media marrin koncesione qeveritare dhe fonde publike për një biznes tjetër të pronarit të medias, koncesione apo fonde që zakonisht nuk jepen për rritjen e pluralizmit të mediave apo për prodhimin e përmbajtjes që i shërben interesit publik. Në vend të kësaj, këto fonde mund të çojnë në forcimin e mëtejshëm të strukturave ekzistuese të pushtetit brenda sektorit të mediave, duke konsoliduar kështu ndikimin e disa pronarëve të mediave dhe duke kufizuar hapësirën e gazetarisë së lirë dhe të pavarur.

Në Shqipëri, transmetuesit kombëtar, RTSh-së, i jepen fonde publike për të ofruar shërbime cilësore për informimin, edukimin dhe argëtimin e publikut, përfshirë minoritetet, siç kërkohet me ligj.⁴⁹ Vihet re se RTSH në një nga kanalet e saj publikon lajme dhe programe kulturore në gjuhët e pakicave, si greqisht, maqedonisht dhe gjuhën rome. Si për krahasim, mediat komunitare që u shërbejnë minoriteteve varen kryesisht nga reklamat dhe sponsorizimet për fonde, pa ndonjë mekanizëm financiar të posaçëm për t'i mbështetur ato përtej këtyre burimeve të të ardhurave. Deri më sot nuk është dhënë asnjë subvencion apo fond për prodhimin e programeve, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të gazetarëve dhe shoqatave të medias për të advokuar për subvencione që do të nxisnin diversitetin në programin e mediave.

— A.5 REKLAMAT SHTETËRORE NË SEKTORIN PRIVAT TË MEDIAVE

Praktikat e reklamave shtetërore në Shqipëri janë një shqetësim i madh për shkak të mungesës së një rregulloreje të qartë dhe transparencës. Ndarja e fondeve për reklamat shtetërore është kritikuar si e dyshimtë dhe potencialisht e njëanshme, duke favorizuar shpesh mediat që mbështesin qeverinë.^{50 51} Mungesa e kuadrit të posaçëm ligjor që rregullon shpërndarjen e reklamave shtetërore do të thotë që fondet mund të ndahen në mënyrë selektive, duke përforcuar kështu klientelizmin dhe duke çuar në autocensurë tek mediat që varen nga një financim i tillë.

Gjendja aktuale e rregullimit të reklamave në Shqipëri, veçanërisht në mediane shkruar dhe atë online, tregon një boshllëk të madh në kuadrin rregullator përkatës. Në situatën e tanishme, praktikat e reklamimit në këto media rregullohen vetëm nga detyrimet e përgjithshme tatimore të biznesit, pa mbikëqyrje të specializuar se si blihet, shitet ose shpërndahet hapësira për reklama. Ndryshe nga media audiovizive, e cila monitorohet nga AMA për volumin e reklamave, mediave të shkruara dhe atyre online u mungon një kontroll i ngjashëm për sa i përket praktikave të reklamimit.

Kuvendi i Shqipërisë e ka shprehur në mënyrë të përsëritur nevojën për reformë. Në rezolutat e tij për performancën

49 Ligji 97/2013, Neni 91 në lidhje me Nenin 113/1/a

50 Instituti Shqiptar i Medias. 2019. "[Tregu i reklamave në median shqiptare](#)," aksesuar më 23 maj 2024.

51 Nenet 3 (paragrafi 28) dhe 40 i Ligjit 97/2013 japin përkufizimin dhe konceptin e reklamës institucionale, duke synuar të mbështesin vlerat e demokracisë, mirëqenies, shëndetit publik dhe sigurisë kombëtare.

e AMA-s për vitin 2023,⁵²⁵³ Kuvendi i kërkoi AMA-s të propozonte ndryshime për të përmirësuar legjislacionin që rregullon reklamën për ta përafuar atë me standardet ndërkombëtare. Ky rekomandim i vazhdueshëm⁵⁴ nënvizon një njohje nga ana e ligjvënësit i nevojës për një rregullim më të fortë dhe transparent që mund të rrisë potencialisht integritetin dhe paanshmërinë e reklamimit në media.

Udhërrëfyeni për Shtetin e së Drejtës i lidhur me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE parashikon që deri në vitin 2025 AMA të ketë krijuar një sistem transparent të matjes së audiencës së medias.⁵⁵ Me anë të këtij sistemi të matjes së audiencës synohet të sigurohen statistika të besueshme që do të informonin për shpërndarjen e barabartë të të ardhurave nga reklamën bazuar në madhësinë faktike të audiencës – gjë që përbën një ndryshim të madh nga praktika aktuale. AMA nisi procesin e konsultimit me përfaqësues nga mediat audiovizive në dhjetor 2023,⁵⁶ ku u organizuan dy tryeza, por nuk u ftuan të merrnin pjesë organizata të shoqërisë civile apo aktorë të tjerë.⁵⁷ Procesi ka nevojë për më shumë transparencë dhe gjithëpërfshirje të palëve të paanshme të interesit.

Aktualisht, shpërndarja e reklamave ndikohet shumë nga kompanitë ndërmjetëse, të cilat mund të manipulojnë dhënien e reklamave për të favorizuar disa media ndaj të tjerave, shpesh bazuar në përkatësinë politike të perceptuar të medias.⁵⁸ Kjo praktikë është shqetësuese, sepse bën që mediat kritike ndaj qeverisë apo që mbështesin opozitën të jenë në disavantazh, duke marrë kështu më pak të ardhura nga reklamën për shkak të frikës që kanë bizneset për dëmtimin e marrëdhënieve të tyre me qeverinë.⁵⁹

Institucionet shtetërore mund t'i kanalizojnë fondet për mediat në mënyrë të tërthortë duke përdorur kompani apo agjenci të shërbimeve të reklamave, shpesh pa përcaktuar kritere ose specifika për shpërndarjen e fondeve. Kjo mungesë transparence e bën mjaft të vështirë të kuptohet se si shpërndahen këto fonde.⁶⁰ Po ashtu, reklamën politike gjatë fushatave elektorale luajnë një rol të rëndësishëm duke ndikuar në përmbajtjen dhe praktikën e mediave. Pronarët e mediave, në disa raste, përdorin mediat e tyre si mjete për të fituar favorin e qeverisë ose subjekteve të tjera me ndikim, duke përdorur shtrirjen dhe ndikimin e platformës së tyre për të negociuar për përfitime ose trajtim të preferencial.⁶¹ Kjo ndërthurje e pronësisë së medias dhe agjendave politike mund të ndikojë ndjeshëm në paanshmërinë dhe besueshmërinë të raportimit të mediave.

52 Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). 2024. "[Raporti Vjetor – AMA – 2023](#)," aksesuar më 23 maj 2024.

53 Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. 2024. "[Rezoluta për Vlerësimin e Veprimtarisë së AMA për Vitin 2023](#)" aksesuar më 23 maj 2024.

54 Ky rekomandim është ripërsëritur në rezolutat e Kuvendit për AMA-n si në vitin 2021 ashtu edhe në 2022.

55 Konsultimi Publik. 2023. "[Udhërrëfyeni për Shtetin e së Drejtës – Kapitulli 23 'Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore'](#)" aksesuar më 23 maj 2024.

56 Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). 2023. "[AMA Organizon Tryezën e Parë për Matjen e Audiencës: Palët Bien Dakord për Krijimin e Grupit të Punës dhe Diskutimin e Modaliteteve për Realizimin e Procesit](#)" aksesuar më 23 maj 2024.

57 Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). 2023. "[AMA Organizon Tryezën e Dytë për Matjen e Audiencës: Palët Bien Dakord për Ngritjen e Komitetit të Përbashkët të Industrisë me 9 Anëtarë](#)" aksesuar më 23 maj 2024.

58 IREX. 2023. "[Barometri i informimit aktiv: Shqipëria](#)," aksesuar më 23 maj 2024.

59 Intervistë me ekspert të medias, Tirana, 5 mars 2024.

60 Megjithatë, reklamimi në mediat dhe rrjetet sociale po bëhet tipari kryesor i fushatave zgjedhore, fushë në të cilën nuk janë përcaktuar ende rregulla për transparencën. Lexoni më shumë për fushatën e zgjedhjeve vendore 2023 në Reporter.al. "[Fushata në Instagram dhe Facebook Kushtoi 91 Mijë USD](#)" aksesuar më 23 maj 2024.

61 IREX. 2023. "[Barometri i informimit aktiv: Shqipëria](#)," aksesuar më 23 maj 2024.

Raporti Vjetor i KE-së 2023 për Shqipërinë thekson se Shqipëria ka ende nevojë të hartojë ligje për përmirësimin e transparencës së reklamave shtetërore në përputhje me standardet e BE-së.⁶²

— A.6 DISPOZITAT LIGJORE PËR SHPIFJEN DHE ZBATIMI E TYRE NUK PRODHOJNË EFEKTE FRENUESE PËR GAZETARËT DHE MEDIAT

Në legjislacionin shqiptar shpifja klasifikohet si kundërvajtje penale, gjë që bie ndesh me praktikat më të mira ndërkombëtare. Kodi Penal e përkufizon shpifjen si përhapje të qëllimshme të informacionit të rremë me qëllim cenimin e dinjitetit dhe nderit të një personi tjetër, dhe përcakton gjoba që variojnë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion e pesëqind mijë lekë (500 euro deri në 15,000 euro). Dënimet e tilla rriten për shpifje të kryera botërisht, në dëm të shumë personave, ose kur kryhet më shumë se një herë, me gjoba që arrijnë deri në tre milionë lekë (30,000 euro).⁶³ Dënimet me heqje lirie për shpifje u hoqën në vitin 2012. Gjithsesi, Kodi krijon një mjedis ligjor me efekt të dyfishtë tkurrjeje për lirinë e medias duke pasur parasysh faktin që përveç kallëzimeve penale, sipas Kodit Civil, ndaj çdo njeriu (përfshirë këtu edhe gazetarët) mund të ngrihen padi civile nëse ai/ ajo publikon të dhëna të pasakta, të paplota ose mashtruese, të cilat cenojnë nderin, personalitetin ose reputacionin e të dëmtuarit, i cili ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me padi civile.⁶⁴ Në kushte të tilla, kuadri ligjor krijon potencialin dhe barrën e tij të rëndë në dëm të gazetarëve duke shtypur lirinë e shprehjes dhe lirinë e shtypit. Për më tepër, gjodat në shuma të konsiderueshme të padive penale dhe civile për shpifje mund të ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë financiare të mediave, veçanërisht atyre të vogla.

Organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri po punojnë intensivisht për dekriminalizimin e plotë të shpifjes dhe po bëjnë thirrje për një rishikim të gjobave për t'i përafuar ato me standardet e BE-së.⁶⁵ Kërkesat e tyre burojnë nga një analizë e vendimeve të gjykatave dhënë gjatë viteve të fundit, nga të cilat evidentohet se gjodat janë tejet të rënda, dhe, të ndërthurura me kostot financiare për gazetarët, vonesat procedurale dhe kërcënimin për padi penale, mund t'i detyrojnë gazetarët drejt autocensurës. Edhe pse në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës përfshihet një masë e posaçme për dekriminalizimin e shpifjes, ende nuk është ndërmarrë asnjë nismë ligjore për trajtimin e kësaj çështjeje. Nga ana tjetër, organizatat e shoqërisë civile kanë kërkuar një përcaktim të qartë ligjor të SLAPP-ve në Shqipëri.⁶⁶

Nga të dhënat e mbledhura për këtë raport nëpërmjet kërkesave për informacion zyrtar, gjatë vitit 2023 evidentohet një rritje e padive ndaj gazetarëve. Që nga viti 2022, në Shqipëri janë hapur gjithsej 30 çështje gjyqësore kundër gazetarëve apo punonjësve të medias, sipas Nenit 119 (Fyerja) dhe Nenit 120 (Shpifja),

62 Komisioni Evropian. "Albania 2023 Report," aksesuar më 5 prill 2024.

63 Neni 120 i Kodit Penal.

64 Kodi Civil, përkatësisht Neni 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta"; Neni 625 "Përgjegjësia për dëmin jopasuror" dhe Neni 647/a "Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësive civile dhe të masës së dëmit jopasuror".

65 SCiDEV. 2024. "SCiDEV organizon diskutime shumëpalëshe për sigurinë e gazetarëve," aksesuar më 23 maj 2024.

66 SCiDEV. 2023. "Mendime për udhërrëfyesin për mediat në Shqipëri: 31 tetor 2023," aksesuar më 23 maj 2024.

parashikuar nga Kodi Penal. Po ashtu, në vitin 2022 janë bërë 12 padi civile, nga të cilat 11 janë sipas Nenit 617 (Publikime mashtruese ose të pasakta) dhe një padi në bazë të Nenit 625 (Përgjegjësia për dëmin jopasuror). Që nga viti 2023, Gjykata e Lartë shqyrtoi dy padi, një penale dhe një civile. Gjykata e Apelit ka shqyrtuar 28 padi, nga të cilat 21 civile dhe 7 penale. Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë shqyrtoi 38 padi civile që përfshinin gazetarë dhe punonjës të medias. Nga ana tjetër, në gjykatat në Elbasan, Gjirokastrë, Durrës dhe Lezhë janë regjistruar pesë padi civile, pa asnjë rast të ngjashëm të raportuar në gjykata të tjera të vendit gjatë gjithë vitit.⁶⁷

Nuk ka ende një regjistër elektronik të posaçëm për paditë dhe çështjet që lidhen me gazetarët, ndonëse duke filluar që nga viti 2023 sistemi aktual në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e ka bërë të mundur një kategorizim të tillë. Krijimi i këtij sistemi elektronik është edhe një tregues i përcaktuar në udhërrëfyesin për shtetin ligjor. Të dhënat e disponueshme nuk arrijnë në ndonjë përfundim që vendimet e gjykatave kundër gazetarëve në Shqipëri të ndikohen nga motive politike. Ka shqetësime për vonesat në gjykimin e çështjeve dhe një paqartësi të përgjithshme për rezultatet e proceseve gjyqësore. Megjithatë, vlen të përmendet se në vitin 2023 nuk u dënua me burg asnjë gazetar. Nga një ndarje më e detajuar e dënimeve të aplikuara ndaj gazetarëve në vitin 2023, gjithsesi, do të bëhej e mundur një pamje më e qartë e mjedisit gjyqësor me të cilin përballen gazetarët. Për më tepër, disa ekspertë kanë vënë një rënie të cilësisë së jurisprudencës, duke ia atribuar këtë rënie lëvizjes së gjyqtarëve, punësimit të gjyqtarëve të rinj në sistem dhe mungesës së trajnimit të vazhdueshëm gjyqësor.⁶⁸

Lidhur me padinë e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës kundër gazetarit Bledian Koka, në maj të vitit 2023, kryebashkiaku dhe avokati i tij nuk u paraqitën në gjykatë dhe nuk dhanë shpjegime për mungesën e tyre, duke bërë që gjykata të pushonte çështjen.⁶⁹ Megjithatë, vetëm disa javë më vonë, kryebashkiaku i Tiranës e ridepozitoi padinë, e cila është ende në pritje për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.⁷⁰ Po kështu, gjyqi për shpifje ndaj gazetares Juli Ristani, i nisur në vitin 2020 nga Belioza Çoku, ish-drejtoreshë kabineti në Ministrinë e Mbrojtjes, u pushua nga gjyqtari në mars 2024 për shkak të mungesës së paditëses dhe avokatëve të saj.⁷¹

67 Kërkesë për informacion për Këshillin e Lartë Gjyqësor, përgjigja erdhi në 14 janar 2024.

68 SCiDEV. 2024. "[SCiDEV organizon diskutime shumëpalëshe për sigurinë e gazetarëve](#)," aksesuar më 23 maj 2024.

69 ResPublica. "[Erion Veliaj Tërhiqet nga Padia për Shpifje ndaj Gazetarit Bledian Koka, Gjykata e Vendos Pushimin e Çështjes](#)" aksesuar më 23 maj 2024.

70 Siç u konfirmua nga avokati i gazetarit, shtator 2024.

71 [Gazetarja Ristani fiton çështjen](#), aksesuar më 23 maj 2024.

— A.7 LIGJET E TJERA ZBATOHEN ME OBJEKTIVITET DHE U BËJNË TË MUNDUR GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAS TË PUNOJNË LIRISHT DHE TË SIGURT

Në Shqipëri, ekziston mundësia që ligjet të zbatohen në mënyrë arbitrare gjë që mund të cenojë lirinë e shprehjes së gazetarëve. Ligjet që trajtojnë çështje si shpifja, gjuha e urrejtjes, e drejta e autorit, privatësia e personit, zbulimi i burimeve të informacionit në një proces penal dhe mbrojtja e të dhënave janë përdorur herë pas here si arsye për pengimin e punës së gazetarëve. Kuadri ligjor në fuqi në Shqipëri, për fat të keq, nuk ofron mbrojtje të posaçme apo masa mbrojtëse për gazetarët që mund të bëhen objekt i Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP).

Ndihma ligjore e garantuar nga shteti në bazë të Ligjit 111/2017 ofron të vetmen mundësi për shmangien e taksave gjyqësore dhe marrjen e ndihmës juridike falas. Megjithatë, gazetarët nuk janë mes përfituesve të këtij ligji, i cili zbatohet për kategori të caktuara, siç janë personat me aftësi të kufizuara dhe viktimat e abuzimit seksual ose trafikimit. Pra, nëse ndaj gazetarëve ngrihen padi SLAPP, ata duhet të paguajnë një avokat për mbrojtje profesionale.

Në vitin 2023, ka pasur disa raste të padive të shumta që janë ngritur nga individë apo grupe të fuqishme kundër gazetarëve me pretendim për shpifje por me qëllim pengimin e hetimeve dhe kronikave të gazetarëve për praktika korruptive ose të paligjshme. Në vitin 2023, gazetarja Klodiana Lala u përball me dy padi për shpifje të ngritura nga Jamarber Malltezi, dhëndri i ish-kryeministrit Sali Berisha. Berisha, lider historik i Partisë Demokratike, aktualisht ndodhet në arrest shtëpie për shkak të një rasti të dyshuar korrupsioni. Në maj 2019, Shtetet e Bashkuara njoftuan shpalljen non-grata të Sali Berishës për veprime që cenojnë demokracinë në Shqipëri.

— A.8 KONFIDENCIALITETI I BURIMEVE TË GAZETARËVE GARANTOHET ME LIGJ DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET

Sipas Nenit 159/3 të Kodit të Procedurës Penale, ruajtja e sekretit profesional shtrihet edhe tek gazetarët profesionistë lidhur me emrat e personave nga të cilët ata kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Por kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij. Edhe standardet etike i detyrojnë gazetarët të ruajnë konfidencialitetin e burimeve të tyre. Pavarësisht kompleksitetit të kuadrit ligjor që në parim e njeh mbrojtjen dhe ruajtjen e konfidencialitetit të burimit, por edhe kufizimet e tij, gazetarët janë të detyruar nga pikëpamja etike të mbrojnë burimet e tyre, duke përjashtuar edhe pëlqimin e shprehur nga vetë individit në fjalë për zbulimin e burimit.

Në vitin 2023, pati një rast të madh publik në lidhje me zbulimin e burimeve të gazetarit. Elton Qyno, gazetar i televizionit Ora News në Shqipëri, u mor në pyetje për afro shtatë orë më 13 dhjetor 2023, në Tiranë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) dhe iu kërkua konkretisht të tregonte burimet e tij.⁷² Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt dhe organizatat e lirisë së medias⁷³ argumentuan se veprimet e ndërmarra ndaj z. Qyno, përfshirë kontrollin e banesës dhe zyrës së tij dhe sekuestrimin e pajisjeve personale dhe profesionale të tij, përbënin një precedent shqetësues për konfidencialitetin e burimeve për gazetarët dhe profesionistët e medias në Shqipëri. Këto organizata argumentuan se agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të kenë prioritet sigurimin dhe ruajtjen e informacionit lidhur me hetimet përpara se të kthejnë në objekt të punës së tyre gazetarët dhe burimet e tyre.⁷⁴ Kur Gjykata e Lartë⁷⁵ në Shqipëri la në fuqi vendimin e SPAK-ut dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Elton Qyno u ankua në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar anulimin e vendimeve që autorizonin sekuestrimin e materialeve personale dhe të punës të gazetarit, por edhe pezullimin urgjent të çdo veprimi mbi këto materiale.⁷⁶

Siç u raportua edhe më sipër, në vitin 2023, gazetarët në Shqipëri, veçanërisht ata të angazhuar në gazetari investigative mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin, vazhduan të përballen me pengesa në sigurimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve me burimet e informacionit. Ky konstatim është në përputhje me vështirësitë e përjetuara edhe gjatë periudhës së raportit të një viti më parë. Këto vështirësi evidentohen edhe më shumë nga shqetësimet madhore lidhur me sigurinë dhe kushtet e pasigurta të punës me të cilat përballen shpesh gazetarë të tillë, duke ndikuar kështu në lirinë dhe besimin e tyre për të vendosur dhe ruajtur kontakte të rëndësishme burimi informacioni për punën e tyre.

— A.9 GAZETARËT JANË TË LIRË TË USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË KRIJOJNË, TË ANËTARËSOHEN E TË MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE

Në Shqipëri gazetarët nuk kanë nevojë të licencohen nga shteti për të punuar, gjë që është një aspekt pozitiv i lirisë së medias. Në këtë drejtim, duhet theksuar se dispozitat kushtetuese nuk vendosin kufizime për licencimin e gazetarëve, pasi përcaktojnë kufij vetëm për miratimin e legjislacionit që mund të kërkojë autorizimin për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit (neni 22/4 i Kushtetutës.). Në vitin 2023, nuk pati përpjekje për të prezantuar licenca të tilla.

72 SafeJournalists. 2023. "[Reagim lidhur me rastin e gazetarit Elton Qyno](#)," aksesuar më 4 maj 2024.

73 SafeJournalists. 2023. "[Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt dhe organizatat partnere të platformës MFRR dhe Reporterët pa Kufi i dërguan një letër Kreut të SPAK në Shqipëri](#)" aksesuar më 2 maj 2024.

74 SafeJournalists. 2023. "[SafeJournalists: Tmerr për sekuestrimin e pajisjeve të gazetarit dhe presionin ndaj tij për të treguar burimet e informacionit](#)," aksesuar më 2 maj 2024.

75 SafeJournalists. 2024. "[Concerns Shqetësime lidhur me vendimin e Gjykatës së Lartë në Shqipëri lidhur me çështjen e gazetarit Elton Qyno](#)," aksesuar më 2 maj 2024.

76 Qendra Respublica. 2024. "[Gazetari Elton Qyno i drejtohet Gjykatës Kushtetuese](#)" aksesuar më 15 maj 2024.

Në përgjithësi, institucionet publike në Shqipëri kanë hartuar dhe miratuar rregullore për akreditimin e medias. Megjithatë, këto praktika shpesh favorizojnë gazetarët e mediave, duke vënë në disavantazh blogerët, profesionistët dhe gazetarët e pavarur. Është më se e nevojshme të përmirësohen praktikatat e akreditimit që duhet të përshtaten me mjedisin në zhvillim të gazetarisë.

Një çështje madhore që ndikon në aftësinë e gazetarëve për të raportuar në mënyrë efektive në Shqipëri është praktika e zakonshme e zyrtarëve publikë, përfshirë këtu kryeministrin, ministrat dhe drejtuesit e partive politike, për të shpërndarë materiale të përgatitura paraprakisht (audio, video dhe tekst) në vend që të angazhohen drejtpërsëdrejti me mediat. Në vitin 2023, për shembull, kryetari i Bashkisë së Tiranës vazhdoi të shmangte konferencat për shtyp, të përjashtonte gazetarët nga aktivitetet publike dhe të furnizonte mediat me përmbajtje të gatshme për transmetim. Kjo praktikë kufizon jashtë mase lirinë e medias, të drejtën e informimit dhe transparencën, pasi i pengon gazetarët të bëjnë pyetje kritike dhe raportojnë nga çdo aspekt për çështjet me interes publik. Për më tepër, kjo praktikë zbulon probleme më të thella brenda vetë industrisë së medias, pasi shumë media i pranojnë dhe i shpërndajnë rregullisht këto materiale pa kryer verifikimin e duhur, duke mos respektuar standardet e gazetarisë. Kjo nxjerr në pah nevojën urgjente që organet e mediave të vlerësojnë me rigorozitet informacionin e dhënë nga zyrtarët publikë për të siguruar që raportimi i tyre të jetë i balancuar dhe gjithëpërfshirës.

Edhe pse kryeministri dhe ministrat japin çdo javë deklarata për shtyp pas mbledhjeve të Këshillit të Ministrave që nga shtatori 2021, mundësitë ku gazetarët të bëjnë pyetje kritike mbeten të pakta. Në vitin 2023, ashtu si edhe në vitin 2022, këto konferenca vazhduan kryesisht si deklarata të njëanshme për shtyp, duke ofruar fare pak mundësi, në mos asnjë, për ndërveprim me gazetarët. Rrjedhimisht, në këto takime shpesh shiheshin vetëm operatorët e kamerave, me një mungesë të theksuar të gazetarëve. Sipas këtij formati, gazetarëve nuk u jepet paraprakisht programi i takimit apo kohë e mjaftueshme për të përgatitur pyetjet. Kjo situatë nxjerr në pah humbjen e një mundësi të madhe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në punën e qeverisë. Për më tepër, ka prova të komunikimit të qeverisë me gazetarët përmes kanaleve jozyrtare si grupet WhatsApp, diskriminim ndaj mediave të pavarura kur kërkojnë informacion ose komente dhe armiqësi ndaj gazetarëve të perceptuar si përfaqësues të mediave të opozitës. Këto praktika nxjerrin në pah edhe më shumë sfidat me të cilat përballen gazetarët e shtypit në Shqipëri, duke kufizuar kështu aftësinë e tyre për të kryer me efektivitet detyrën e tyre profesionale.

Në vitin 2023, gazetarët hasën në vështirësi për t'u futur në Kuvendin e Shqipërisë. Më 9 nëntor, gazetarët që tentuan t'u bënin pyetje ministrave dhe deputetëve në oborrin e Kuvendit, u penguan nga Garda e Republikës. Gazetarja Klesiana Omeri u pengua fizikisht të kryente detyrën dhe operatorit të

kamerës iu ndalua të filmonte.⁷⁷ Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (SJN) në Shqipëri i ka regjistruar këto incidente, duke theksuar se kemi të bëjmë me një model të përsëritur që përkon me përshkallëzimin e tensioneve politike në Parlament.⁷⁸

Sipas Rregullores për Komunikimin me Media të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP),⁷⁹ në fuqi që nga viti 2022, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, me miratimin e anëtarit përkatës të Këshillit, ka të drejtë të kërkojë nga drejtuesi i medias përkatëse, zëvendësimin e një gazetari të akredituar, nëse ka shkelje të qarta të objektivitetit dhe profesionalizmit, Kushtetutës, ligjit dhe parimeve të rregullores në fjalë. Dispozita të tilla në këtë rregullore kanë një përkufizim mjaft të përgjithshëm për sa i përket arsyeve dhe nuk i bëjnë të mundur gazetarin të mbrohet dhe të dëgjohet në lidhje me shkeljet e supozuara. Lidhur me këtë ka reaguar edhe Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt.⁸⁰

Ndonëse gazetarët në Shqipëri bëjnë pjesë në shoqata profesionale, sfidat me të cilat përballen këto shoqata, si mungesa e konsolidimit, burimet e kufizuara dhe kompetencat e pamjaftueshme, vazhdojnë. Në vitin 2023 nuk u raportuan presione ndaj këtyre shoqatave. Në Shqipëri nuk ka sindikatë të gazetarëve.

— A.10 E DREJTA PËR TË AKSESUAR DOKUMENTE DHE INFORMACIONE ZYRTARE

Gazetarët në Shqipëri hasin shpesh vështirësi për të përdorur ligjet në fuqi për marrjen e dokumenteve dhe informacionit zyrtar, pasi autoritetet shpesh nuk i zbatojnë këto ligje brenda afatit, duke çuar në kufizimin e transparencës dhe rritjen e vështirësive për marrjen e informacionit në kohë, gjë që është me rëndësi të madhe për gazetarët. Ndryshimet ligjore nëpërmjet Ligjit 78/2023⁸¹ në Ligjin 119/2014, "Për të drejtën e informimit", që hyri në fuqi në nëntor 2023, zgjeruan kompetencat e Komisionerit për monitorimin e zbatimit të ligjit. Ndryshimet parashikojnë që Komisioneri, pas kryerjes së një hetimi administrativ, të gjobisë titullarin e institucionit ose zyrtarin që ka penguar dhënien e informacionit sipas kërkesave të ligjit.⁸² Për sa i përket të drejtës për informim, gjatë vitit 2023 Zyra e Komisionerit shqyrtoi 957 ankesa, ku rreth 390 u bënë nga gazetarë dhe 170 nga organizata të shoqërisë civile, duke evidentuar kështu sfidat e vazhdueshme lidhur me transparencën dhe të drejtën e informimit.⁸³

77 Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt. 2023. "[Sulmi ndaj gazetarëve nga Garda e Republikës në Kuvendin e Shqipërisë](#)" aksesuar më 15 maj 2024.

78 Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt. 2023. "[Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt i dërgon letër shqetësimi Kuvendit të Shqipërisë](#)" aksesuar më 15 maj 2024.

79 Rregullore "Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me median" 2022.

80 Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt: Rregullorja e re e Këshillit të Lartë të Prokurorisë shkel lirinë e medias në Shqipëri 2022.

81 Në vitin 2022, ndryshimet që u propozuan në Ligjin Nr. 119/2014, "Për Konsultimet Publike", ngritën shqetësime të mëdha. Ministria e Drejtësisë hartoi një projektligj në tetor 2022, që synonte përmirësimin e legjisllacionit në fuqi për të drejtën e informimit. Gjithsesi, disa aspekte të projektligjit ishin mjaft shqetësuese. Projektligji propozonte uljen e gjobave ndaj autoriteteve publike që nuk jepnin informacionin e kërkuar dhe prezantoi konceptin e "kërkesave abuzive", me anë të të cilit do t'u bëhej e mundur autoriteteve të refuzonin automatikisht pa dhënë arsye pyetjet e përsëritura të gazetarëve, duke penguar kështu gazetarinë investigative dhe duke ulur transparencën e qeverisë. Në përgjithësi, këto propozime përbënin një hap prapa nga standardet aktuale ligjore. Po ashtu, u kritikuan edhe sanksionet e sugjeruara për mosrespektim të vendimeve të Komisionerit, sepse nuk i përgjigjeshin thirrjeve të shoqërisë civile për marrjen e masave. Përçindja e ulët e zbatimit të vendimeve të Komisionerit dhe mungesa e urdhrave të detyrueshëm ishin gjithashtu mangësi të dukshme që nuk trajtoheshin nga ndryshimet e propozuara në ligj. Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt dhe organizata të tjera të gazetarëve shprehën kundërshtimet e tyre dhe kërkuan që të merren parasysh rekomandimet e shoqërisë civile. Pas këtyre shqetësimeve, më 11 prill 2023 u organizua një tjetër takim konsultimi.

82 Reporter.al. 2023. "[Miratohen pa debat ndryshimet në ligjin "Për të drejtën e Informimit"](#)" aksesuar më 3 maj 2024.

83 Kërkesë për informacion, përgjigja erdhi në 15 janar 2024.

Edhe pse Ligji "Për të drejtën e informimit" përcakton procedurat për kërkimin dhe marrjen e informacionit, institucionet priren të përdorin afatin maksimal të lejuar me ligj për t'iu përgjigjur kërkesave ose japin të dhëna që janë të vështira për t'u përdorur. Kjo mund të sjell vonesa në punën e gazetarëve si dhe dëmton aktualitetin e lajmit, duke i detyruar gazetarët të kërkojnë informacione nga burime alternative. Organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e medias dhe grupet ndërkombëtare për lirinë e shtypit kanë shprehur shqetësime të vazhdueshme për vendimin e qeverisë shqiptare për të centralizuar marrëdhëniet me publikun dhe informimin nëpërmjet krijimit në shtator 2021 të Agjencisë për Media dhe Informim (AMI). Kritikët⁸⁴ argumentojnë se ky centralizim kufizon të drejtën e informimit dhe rrit kontrollin e qeverisë mbi qarkullimin e informacionit.⁸⁵

Pavarësisht pretendimeve të drejtorit të AMI-t se agjencia ka përmirësuar transparencën e qeverisë duke riorganizuar faqet ueb të ministrive dhe duke përmirësuar komunikimin me mediat,⁸⁶ shqetësimet vazhdojnë për rolin e agjencisë në centralizimin e informimit publik. Ka shqetësime të veçanta në lidhje me autoritetin e tij për të emëruar dhe shkarkuar zëdhënësit dhe funksionin e agjencisë për monitorimin e aktiviteteve publike të ministrave, gjë që mund të rrisë mbikëqyrjen dhe kontrollin e qeverisë mbi informacionin.⁸⁷ Për më tepër, struktura e Agjencisë ka bërë që të rriten kritikët për shtimin e procedurave burokratike që menaxhojnë dhe delegojnë tek autoritetet përkatëse kërkesat për informim, duke e komplikuar procesin në vend që ta thjeshtojnë atë. Ky centralizim shihet edhe si një formë kontrolli të strukturuar mbi informacionin që hyn dhe del nga dega e ekzekutivit dhe zyra e Kryeministrit, gjë që jo domosdoshmërisht mund të sjellë shpërndarje më të mirë apo më të shpejtë të informacionit te publiku. Pas dy vitesh në funksionim, shqyrtimi nga AMI i një numri minimal kërkesash për informim ka sjellë dyshime për efikasitetin e saj dhe arsyetimin për financimin e saj me fonde publike.⁸⁸ Krijimi dhe funksionimi i AMI-t, siç është konceptuar aktualisht, konsiderohen si hapa që më shumë minojnë demokratizimin dhe transparencën sesa i mbështesin ato.

Në vitin 2023, ka pasur raste ku institucionet publike kanë aplikuar tarifa tepër të larta për dhënien e informacionit palëve të interesuara, të njohura si kosto të riprodhimit të dokumenteve, pavarësisht dispozitave ligjore. Sipas Nenit 13 të ligjit, informacioni i kërkuar në mënyrë elektronike është pa pagesë, ndërkohë që tarifat për riprodhimin e dokumenteve që kërkohen të merren duhet të jenë përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Ky nen përjashton nga tarifat qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe për përfituesit sipas Ligjit 10039, "Për ndihmën juridike". Megjithatë, siç u përmend më sipër, gazetarët

84 Faktoje.al. 2023. "[Liria e shprehjes dhe medias në raportin e Komisionit Evropian: Rekomandimet e grupeve të interesit](#)" aksesuar më May 14 2024.

85 Shqetësime për AMI-n edhe nga [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt](#), [Media Freedom Rapid Response](#) dhe [Respublica](#).

86 Reporter.al. 2022. "[Dukem naiv, por jam idealist](#)", [Endri Fuga mbron Agjencinë e Medias dhe Informimit](#)" aksesuar më 20 qershor 2024.

87 Shqetësime për AMI-n edhe nga [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt](#), [Media Freedom Rapid Response](#) dhe [Respublica](#).

88 Respublica. 2023. "[Raport për të drejtën e informimit në Shqipëri](#)" aksesuar më 3 korrik 2024.

nuk bëjnë pjesë të përfituesit e këtij ligji. Hasen edhe probleme të tjera: tarifat e vendosura nga Komisioneri i tejkalojnë kostot aktuale për shërbimet e fotokopjimit në treg, gjë që bie në kundërshtim me nenin 13 të ligjit. Po ashtu, autoritetet vazhdojnë të aplikojnë tarifa jo të njëjta dhe dispozitat për dhënie falas të informacionit në rrugë elektronike nuk respektohen gjithmonë. Shpesh autoritetet pretendojnë se u mungojnë versionet elektronike të dokumenteve, duke i fryrë artificialisht tarifat e fotokopjimit të tyre.⁸⁹ Një shqetësim tjetër është se autoritetet publike refuzojnë të japin informacion edhe kur gjykata urdhëron dhënie të informacionit, duke u bërë kështu pengesë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.⁹⁰ Në aspektin pozitiv, gati gjysma e autoriteteve kanë përbushur gjysmën ose më shumë se gjysmën e kërkesave ligjore për programet e transparencës.⁹¹

Për sa i përket transparencës së gjykatave, portali i konsoliduar online i gjykatave (gjykata.gov.al) nuk lejon aksesin në pjesën më të madhe të vendimeve gjyqësore, madje as profesionistëve ligjorë që mbështeten te këto dokumente në punën e tyre. Avokatëve u lejohet të marrin informacione vetëm kur kanë të bëjnë me rastet e një palë të caktuar që përfaqësojnë, duke përdorur një kod de-anonimizimi. Kjo politikë e mospublikimit të vendimeve gjyqësore ose dhënies së informacionit për dosjet gjyqësore pasi një vendim të ketë marrë formë të prerë është mjaft e përhapur në veprimtarinë e institucioneve të reja gjyqësore. Strategjia e komunikimit e Këshillit të Lartë Gjyqësor për 2022-2025⁹² nuk e trajton këtë çështje, pavarësisht shqetësimeve të shpeshta të shprehura nga media dhe shoqëria civile. Ndërkohë, gazetarët dhe hulumtuesit, si kontrollues të mundshëm të të dhënave, mund të sigurojnë anonimatin gjatë marrjes së dosjeve, duke mbrojtur kështu interesin publik pa cenuar privatësinë e të dhënave.

Në vitin 2023, disa shqetësime për aksesin e mediave në Parlament mbetën të pandryshuara.⁹³ Në vitin 2021, Kuvendi i Shqipërisë zbatoi një Rregullore për Akreditimin, Akomodimin dhe Orientimin e Masm medias, e cila hasi në kritika.⁹⁴ Pavarësisht disa ndryshime pas konsultimit me komunitetin e medias, rregullorja ende kufizon lirinë e lëvizjes së gazetarëve brenda mjediseve të Kuvendit, duke u kufizuar gazetarëve të mediave private përdorimin e një dhomë të caktuar për lajme dhe duke i ndaluar ata të raportojnë drejtpërsëdrejti nga seancat plenare apo mbledhjet e komisioneve ose të lëvizin lirshëm në të gjithë ndërtesën, ndryshe nga homologët e tyre të transmetuesit publik RTSH dhe agjencisë së lajmeve ATSH, të cilët kanë akses më të pakufizuar.⁹⁵ Një gjë e tillë ka krijuar shqetësime për krijimin e një sistemi diskriminues aksesit dhe kufizimit të transparencës.

Ndonëse legjislatura aktuale ka bërë disa përparime në drejtim të rritjes së transparencës duke ofruar më shumë të

89 Shembulli i Njësisë Administrative Mezhgoran, [Bashkia Tepelenë](#) kërkoi 1,200 euro për të dhënë informacione.

90 Respublica. 2023. "[Raport për të drejtën e informimit në Shqipëri](#)," aksesuar më 3 korrik 2024.

91 KDIMDHP. 2024. [Raport vjetor 2023](#), aksesuar më 12 gusht 2024.

92 [Plani Strategjik i Komunikimit për Sistemin Gjyqësor i Këshillit të Lartë Gjyqësor](#), aksesuar më 13 korrik 2024.

93 Diskutim në fokus grup me reporterë, 5 mars 2023.

94 Njoftim i Rrjetit i Gazetarëve të Sigurt, 4 tetor 2021.

95 Diskutim në fokus grup me reporterë, 5 mars 2023.

dhëna statistikore mbi aktivitetet e Kuvendit dhe konsultime për standardet e transparencës,⁹⁶ ka ende aspekte të rëndësishme që kanë nevojë për përmirësim. Kohëzgjatja dhe lehtësia e përdorimit të dokumentacionit të publikuar nga Kuvendi, siç janë procesverbalet nga seancat dhe mbledhjet e komisioneve, mbeten të pamjaftueshme.⁹⁷ Edhe pse faqja e internetit e Kuvendit është rikrijuar për lehtësuar marrjen e informacionit dhe transmetimet e drejtpërdrejta të takimeve janë të publikuara në faqen e tij zyrtare në Facebook, këto masa janë të pamjaftueshme për transparencë dhe akses të plotë tek informacioni.⁹⁸

Për më tepër, në nëntor 2023,⁹⁹ Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt i paraqiti Kryetares së Kuvendit shqetësimet e tij lidhur me aksesin e gazetarëve në mjediset e Kuvendit. Janë vënë re raste kur gazetarët janë penguar nga Garda e Republikës t'u bënin pyetje ministrave dhe deputetëve, duke cituar "direktivat e reja" që u kufizonin gazetarëve aksesin në zona të caktuara edhe jashtë ndërtesës së Kuvendit, duke i penguar ata të bënin intervista dhe të raportonin në mënyrë efektive. Kjo mbështetje në direktivat e paqarta dhe urdhrat verbalë të Gardës rrezikon të krijojë një mjedis shtypës për median,¹⁰⁰ liria e të cilës është vendimtare për informimin e publikut. Pavarësisht nga premtimet për rishikimin e rregullores, deri më sot nuk janë bërë ende ndryshime në të dhe incidentet me kufizimet e imponuara nga Garda vazhduan edhe në gjysmën e parë të 2024.¹⁰¹

96 ATA. 2024. "[Nikolla nënshkruan deklaratën, Kuvendi angazhim për zbatimin e standardeve të Transparencës](#)" aksesuar më 20 korrik 2024.

97 IDM. 2024. [Vlerësimi i Sistemit Kombëtar të Integritetit në Shqipëri](#).

98 Faktoje.al. 2023. "[Liria e shprehjes dhe medias në raportin e Komisionit Evropian: Rekomandimet e grupeve të interesit](#)", aksesuar më 14 maj 2024.

99 [Njoftim i Rrjetit të Gazetarëve të Sigurt](#), 9 nëntor 2023.

100 Intervistë e thelluar me reporter të politikës, Tirana, mars 2024.

101 [Njoftim i Rrjetit të Gazetarëve të Sigurt](#), 30 maj 2024.

B. POZICIONI I GAZETARËVE NË REDAKSITË E LAJMEVE

— B.1 VENDI I PUNËS I GAZETARËVE ËSHTË I GARANTUAR DHE I MBROJTUR NË MJEDISIN E PUNËS

Situata lidhur me kushtet e punës së gazetarëve në Shqipëri mbeti e pandryshuar edhe në vitin 2023. Ndonëse shumica e gazetarëve janë të punësuar me kontrata të rregullta, të drejtat e tyre të punës shpesh nuk respektohen tërësisht. Problematika të zakonshme janë vonesat e pagave, marrëveshjet informale për kalimin e një pjese të pagës në dorë, pagesa të pamjaftueshme të sigurimeve shoqërore, oraret e zgjatura të punës, ditët e kufizuara të pushimeve dhe pushimet nga puna në mënyrë të paligjshme.¹⁰² Për më tepër, disa gazetarë, si korrespondentët në rrethe apo gazetarët e portaleve online, janë të punësuar me kontrata shërbimi dhe jo me kontrata të rregullta pune.¹⁰³ Këto kontrata sigurojnë mbrojtje minimale ligjore për këta punonjës, duke kontribuar kështu në përkeqësimin e kushteve të punës për gazetarët.¹⁰⁴

Gjatë vitit 2023, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt raportoi raste të shumta të shkeljeve të të drejtave të gazetarëve në Shqipëri. Një rast i bujshëm ishte ai i disa gazetarëve dhe punonjësve të medias nga RTSH, të cilët pretendonin se ishin shkarkuar si pjesë e ristrukturimit organizativ pas marrjes së drejtimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ri.¹⁰⁵ Edhe pse ky i fundit ka kompetencën ligjore të marrë në punë dhe të pushojë drejtorë drejtorie dhe shefa sektorësh, është e nevojshme që këto vendime të zbatohen me transparencë dhe në përputhje me të drejtat e punës që garantojnë mbrojtjen e gazetarëve. Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt kërkoi hollësi për numrin e gazetarëve dhe personelit të medias të prekur nga këto shkarkime, por RTSH nuk dha përgjigje. Shqetësimet për këto praktika në RTSH janë ngritur edhe nga deputetë e aktorë të tjerë që nga muaji qershor 2023.¹⁰⁶

Në vitin 2023, gazetarët dhe punonjësit e medias në Shqipëri u përballën me kushte të vështira pune dhe pasiguri ekonomike, duke bërë që në Inspektoratin Shtetëror të Punës¹⁰⁷ të paraqiten 26 ankesa ndaj 5 subjekteve.¹⁰⁸ Këto ankesa kishin të bënin kryesisht me probleme të tilla si paga të papaguara, orët jashtë orarit të papaguara dhe puna edhe në ditët e pushimeve zyrtare si dhe problemet që lidhen me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të ankesave, përfshirë këtu edhe ato nga punonjësit e RTSh-së, shumë gazetarë dhe punonjës të medias hezitojnë të denoncojnë publikisht. Shpesh hezitimi i tyre vjen

102 Diskutime në fokus grup, 5 mars 2024.

103 Intervistë e thelluar me gazetar ueb, 3 prill 2024.

104 Intervistë e thelluar me korrespondent në rrethe, 17 prill 2024.

105 Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt. 2023. [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt i dërgon letër shqetësimi RTSh-së, Kuvendit të Shqipërisë, AMA-s](#), aksesuar më 23 prill 2024.

106 Balkan Insight. 2023. [Ankesa për pushime të padrejta nga puna në televizionin publik](#), aksesuar më 23 prill 2024.

107 Sipas [Barometrit të të Drejtave të Njeriut të KSHH-së 2023](#), bazuar në shkeljet e raportuara gjerësisht nga përfaqësues të sindikatave dhe organizatave që mbulojnë katër sektorët e sipërpërmendur, është shqetësues fakti se Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale i mungojnë statistikave apo informacione cilësore lidhur me ankesat e punëtorëve të fasonerive, minierave, call center-ave dhe mediave. Shpjegimi i dhënë për këtë mungesë të dhënash është se klasifikimi i sektorit ndjek kategoritë e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Objektivist, kjo krijon perceptimin e publikut për mungesën e efektivitetit nga ana e Inspektoratit për t'iu përgjigjur me transparencë dhe përgjegjshmëri sfidave me të cilat përballen sektorët më të cenueshëm për sa i përket marrëdhënieve të punës.

108 Kërkesë për informacion, përgjigja erdhi në 15 janar 2024.

për shkak të frikës nga pasojat, burimeve të kufizuara dhe shqetësimeve për perspektivat e punësimit në të ardhmen.¹⁰⁹

Gazetarët në Shqipëri përballen edhe me kërcënimet në rritje të sigurisë dixhitale, të tilla si hakerimet dhe fushatat e shpifjeve, të cilat janë veçanërisht më të theksuara ndaj grave gazetare, ato që punojnë në mediat online dhe mbrojtëset e të drejtave të njeriut.¹¹⁰ Mungesa e kontratave të rregullta e vështirëson mbrojtjen e të drejtave të pronësisë së tyre intelektuale dhe krijimin e identitetit të tyre profesional. Për më tepër, nga disa shkelje të rënda me të dhënat personale në vitin 2021 dhe nga një sulm i madh kibernetik në vitin 2022 u bënë publike informacione të ndjeshme, përfshirë këtu detaje të llogarive bankare, duke rritur kështu shqetësimet për sigurinë dhe privatësinë e gazetarëve dhe burimeve të tyre.¹¹¹

Gazetarët e pavarur në Shqipëri përballen me kushte të pasigurta, duke hasur në vështirësi për të hyrë në institucione, për t'u njohur profesionalisht, për të marrë pagesat në kohë dhe për të përfituar sigurimet shoqërore. Këto vështirësi gjë përkeqësojnë cënueshmërinë e tyre.

Ndonëse Kodi i Punës i Shqipërisë lejon që çdo grup prej të paktën 20 punonjësish të krijojnë një sindikatë për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre, gazetarët dhe punonjësit e medias në vend ende nuk e kanë krijuar një sindikatë të tyre. Shumë gazetarë përmendin frikën e hakmarrjes nga pronarët e mediave si një nga arsyet kryesore për mungesën e sindikalizimit.¹¹² Për më tepër, nuk ka dispozita ligjore që gazetarët të përfitojnë ndihmë juridike falas nga mediat e tyre; nuk ka as marrëveshje kolektive për të mbrojtur të drejtat e punës së gazetarëve në sektorin e mediave private. Kjo mungesë e sindikatave dhe marrëveshjeve kolektive i lë gazetarët pa mbrojtje dhe pa mbështetje të mjaftueshme në vendin e punës.

— B.2 PAVARËSIA EDITORIALE NË MEDIAT PRIVATE

Në vitin 2023 nuk u evidentuan përmirësime të konsiderueshme faktike në autonominë editoriale të mediave private në Shqipëri. Kufizimet e burimeve shpesh bëjnë që disa punonjës të mbulojnë përgjegjësi e detyra të shumta, duke eklipsuar dallimin mes redaksive dhe roleve të tyre në menaxhim apo marketing. Pavarësisht ekzistencës së udhëzimeve për funksionimin në disa media të mëdha private për të siguruar pavarësinë editoriale, zbatimi në praktikë mbetet i paqëndrueshëm. Ndikimi i mediave që mbështesin një palë dhe marrëdhëniet e ndërthurura mes pronarëve të mediave, përkatësive politike, interesave të biznesit dhe krimit të organizuar gërryejnë vazhdimisht autonominë editoriale.¹¹³

109 Diskutime në fokus grup, 5 mars 2024.

110 IDM. 2023. [Studim: Liria për të mbrojtur të drejtat në hapësirat online: Sfida për gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut në Shqipëri](#), aksesuar më 31 maj 2024.

111 SCIDEV. 2022. Hartëzimi i shkeljeve të të dhënave personale në Shqipëri: Një retrospektivë e shkurtër mbi shkeljet masive në vend", aksesuar më 30 prill 2024.

112 Sipas [Barometrit të të Drejtave të Njeriut të KSHH-së 2023](#), punëdhënësit janë pengesa kryesore për formimin e sindikatave. Ata shpesh pushojnë aplikantët ose palët e interesuara menjëherë pas paraqitjes së një kërkesë për krijimin e sindikatës ose i diskriminojnë ata në krahasim me punonjësit e tjerë.

113 Monitori i Pronësisë së Mediave në Shqipëri. 2023. ["Shqipëria: Përmbledhje e pronësisë së mediave"](#) aksesuar më 13 korrik 2024.

Pavarësia editoriale është baza për besueshmërinë dhe besimin te mediat. Megjithatë, ky aspekt jetësor mbetet i pasigurt në Shqipëri. Të kontrolluara nga një pjesë e vogël e bizneseve me ndikim dhe me lidhje politike, mediat private hasin vështirësi në ruajtjen e autonomisë, veçanërisht pasi pronarët kanë interesa në sektorë të rregulluar, të tillë si ndërtimi. Pavarësisht nga ekzistenca e udhëzimeve për funksionimin e tyre në mediat e mëdha, ndikimi i partive politike, interesat e biznesit, madje edhe lidhjet me krimin e organizuar shpesh komprometojnë pavarësinë e vërtetë editoriale.¹¹⁴ Një situatë e tillë jo vetëm që pengon rolin e medias si një mbikëqyrës i paanshëm, por dëmton edhe kapacitetin e saj për të informuar publikun në mënyrë të paanshme. Për më tepër, ka mungesë transparence proaktive në lidhje me pronësinë e mediave dhe autonominë editoriale në pjesën më të madhe të platformave të mediave private në Shqipëri. Këto të fundit vazhdojnë të mbështeten te kodet e jashtme të etikës në vend që të kenë politikat e tyre të brendshme.¹¹⁵ Ndonëse në këtë praktikë nuk ka ndryshime të konsiderueshme në krahasim me vitin e kaluar, situata mbetet shqetësuese, pasi redaksitë ende nuk kanë hartuar dhe miratuar udhëzime të qarta dhe të përshtatshme që të sigurojnë respektimin e standardeve etike.

Pronësia e medias në Shqipëri ka ndikuar gjithnjë e më shumë në pavarësinë editoriale të mediave, pasi pronarët i përdorin platformat e tyre në media për të siguruar favore nga qeveria dhe figura të tjera me ndikim.¹¹⁶ Kjo ka çuar në një marrëdhënie shqetësuese simbiotike mes politikës dhe biznesit, duke ndikuar në politikat editoriale si rezultat i ndikimit të padrejtë të burimeve të financimit.¹¹⁷ Për më tepër, në vitin 2023, ashtu si edhe në vitet e mëparshme, u vu re një tendencë shqetësuese ku mediat angazhohen në praktikën e shantazhimit të bizneseve, partive politike ose individëve duke i kërcënuar ata me raportim negativ. Ndryshimet e fundit në pronësinë e disa transmetuesve privatë kanë rezultuar në mbulim mediatik më të favorshëm për qeverinë. Për më tepër, ka raportime alarmante se individë të implikuar në korrupsion dhe pastrim parash po investojnë në biznesin e mediave si pjesë e strategjisë për t'iu shmangur drejtësisë.¹¹⁸ Këto praktika ngrenë pyetje serioze për integritetin dhe pavarësinë e sektorit të medias në Shqipëri.

— B.3 PAVARËSIA EDITORIALE E TRANSMETUESVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

RTSh ka detyrimin ligjor¹¹⁹ të ruajë pavarësinë editoriale dhe të respektojë kodin e sjelljes dhe etikës. Pavarësisht pjesëmarrjes në projektet që synojnë ngritjen e kapaciteteve dhe publikimit të politikës së saj editoriale në internet, vazhdojnë ende shqetësimet lidhur me perceptimet për njëanshmëri në edicionet e lajmeve në favor të partisë në pushtet.¹²⁰

114 Intervistë e thelluar me gazetar të ri, 17 mars 2024.

115 Diskutime në fokus grup, 5 mars 2024.

116 Monitori i Pronësisë së Mediave në Shqipëri. 2023. "Shqipëria: Përmbledhje e pronësisë së mediave" aksesuar më 13 korri 2024.

117 Freedom House. "Shqipëria: Liria në botë 2024," aksesuar më 5 qershor 2024.

118 Raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së për vitin 2023 mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut, aksesuar më 13 korrik 2024.

119 Statusi i RTSh-së.

120 Diskutime në panel për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve të organizuar nga Fakte.al, Cluster 1, SCiDEV, RsF dhe AMC, BIRN dhe SCiDEV.

Respektimi nga gazetarët i Kodit të Sjelljes dhe Etikës¹²¹ të RTSh-së është me rëndësi të madhe për të mbështetur pavarësinë editoriale dhe për të nxitur raportimin e paanshëm, duke theksuar nevojën e vazhdueshme për vigjilencë në garantimin e respektimit të standardeve profesionale.

Sipas ligjit për mediat audiovizive,¹²² RTSh ka detyrimin ligjor që të ketë të ndarë redaksinë nga organet e saj drejtuese, nga Këshilli Drejtues që mbikëqyr veprimtarinë e saj dhe nga Drejtori i Përgjithshëm që merret me menaxhimin e përditshëm. Edhe pse këto struktura synojnë të ruajnë pavarësinë editoriale, ka pasur raste kur ndikimi i drejtuesve ka cenuar autonominë e redaksisë dhe të gazetarëve. Kjo mospërputhje mes teorisë dhe praktikës nxjerr në pah sfidat e vazhdueshme që hasen në respektimin e politikave editoriale, kodit të etikës dhe standardeve profesionale në RTSH.

Ndikimi i qeverisë është kryesisht i tërthortë dhe lidhet me perceptimin se RTSH favorizon partinë në pushtet në edicionet e lajmeve, duke qenë se Këshilli Drejtues i saj zgjidhet nga shumica në Parlament.¹²³

Shqetësimet kryesore lidhur me presionin ndaj gazetarisë nuk burojnë nga presioni i drejtpërdrejtë i qeverisë, por nga marrëdhëniet komplekse dhe të ndërthurura mes drejtuesve të RTSH-së, politikanëve dhe aktorëve të tjerë me ndikim.¹²⁴ Po ashtu, qeveria ushtron presion mbi gazetarët në mënyrë të tërthortë duke zhvlerësuar gazetarinë profesionale dhe duke përdorur fushata shpifëse dhe retorikë antimedia. Forma të tjera presioni janë paditë për shpifje, kërcënimet ligjore kundër gazetarëve investigativë, sulmet kibernetike dhe shkeljet e sigurisë dixhitale.

— B.4 PAVARËSIA EDITORIALE NË SEKTORIN E MEDIAVE JO-FITIMPRURËSE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Drejtoria e Tatimeve nuk kanë të dhëna për mediat jofitimprurëse, pasi nuk ka një kategori të veçantë për to. Organizata jofitimprurëse mund të regjistrohet vetëm si një organizatë, shoqatë, fondacion apo qendër. Disa nga mediat jofitimprurëse më të spikatura në Shqipëri janë BIRN Albania, Faktoje.al, Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore dhe INA media, Citizen Channel, Reporterët e Komunitetit Shqiptar, Amfora, Nyje, Bulqizaimë, etj.

Mediat jofitimprurëse në Shqipëri, të tilla si mediat investigative dhe fakt-verifikuese si dhe mediat me mision, tregojnë një përkushtim më të fortë ndaj pavarësisë editoriale në krahasim me homologët fitimprurës. Këto media shpesh respektojnë Kodin e Sjelljes së Gazetarëve për të ruajtur standardet profesionale dhe për të siguruar pavarësinë. Kodi i Etikës i

121 [Kodi i Etikës, Parimet Editoriale dhe Standardet Profesionale të RTSH-së](#)

122 [Ligji Nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"](#)

123 [Ligji Nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"](#)

124 Shqetësime për marrëdhëniet me [transmetuesin publik turk](#) dhe [zgjedhjen e Z. Peza si Drejtor i Përgjithshëm](#).

Instituti Shqiptar të Medias,¹²⁵ i përditësuar në vitin 2018 me të dhëna nga Këshilli Shqiptar i Medias, përgjithësisht respektohet nga organizata mediatike jofitimprurëse, duke promovuar më tej praktikën etike të gazetarisë dhe autonominë editoriale.

Edhe pse më të pakta në numër dhe më të vogla për nga madhësia në krahasim me homologët e tyre privatë, mediat jofitimprurëse në Shqipëri përballen me sfida të mëdha për sa i përket lirisë së medias, qëndrueshmërisë financiare dhe sigurisë. Këto organizata shpesh vuajnë nga financimi i pamjaftueshëm për zhvillimin dhe zgjerimin e përmbajtjes, ndërkohë që për të penguar gazetarinë investigative zakonisht përdoren paditë SLAPP. Për më tepër, vazhdojnë kufizimet për marrjen e informacionit publik për shkak të mungesës së transparencës së institucioneve publike¹²⁶ dhe kërcënimit të gazetarëve. Këta faktorë të gjithë së bashku pengojnë funksionimin dhe rritjen efektive të mediave jofitimprurëse në Shqipëri.

— B.5 LIRIA E GAZETARËVE NË PROCESIN E PRODHIMIT TË LAJMEVE

Në vitin 2023, ka pasur ende pengesa në sigurimin e pavarësisë editoriale dhe lirisë së shtypit, që janë jetike për ruajtjen e parimeve demokratike dhe lehtësimin në marrjen e informacionit të besueshëm. Kështu, gazetarët shpesh përballen me vështirësi kur përzgjedhin kronikat që do të mbulojnë për shkak të konflikteve të mundshme me pronarët e mediave, me interesat politike ose figura të tjera me ndikim.¹²⁷ Faktorë të tillë si politikën editoriale, dinamikën mes redaksive dhe drejtuesve të medias, dhe struktura e pronësisë së medias mund të ndikojnë në lirinë e gazetarëve për të zgjedhur kronikat ose programet e tyre. Nga ana tjetër, autocensura mbetet e përhapur duke qenë se gazetarët mund të fshehin informacione ose të ndryshojnë përmbajtjen për të shmangur pasojat.¹²⁸ Pavarësisht përpjekjeve për të trajtuar këtë çështje, autocensura ende vazhdon në sektorin e mediave në Shqipëri.

Gazetarët në Shqipëri e pranojnë ndikimin e rreziqeve dhe burimeve të ndryshme të ndikimit, si shqetësimet për sigurinë fizike, presioni i qeverisë dhe kërcënimet nga pronarët e mediave, duke çuar në përhapje të autocensurës.¹²⁹ Gjithsesi, niveli i ndërjegjësimit mes gazetarëve është i ndryshëm ashtu si edhe respektimi i standardeve dhe kodeve të etikës, por që ka mungesë të trajnimit të vazhdueshëm në këtë drejtim. Për më tepër, tek disa gazetarë dhe vihen re praktika joetike raportimi, veçanërisht në mbulimin e çështjeve të ndjeshme sociale ku përfshihen drama, dhunë dhe konflikte.¹³⁰

Në Shqipëri censura dhe autocensura janë probleme të përhapura në median elektronike dhe të shkruar, të

125 [Kodi i Etikës i Gazetarëve](#)

126 BIRN 2024 'Liria e informimit: Raporti vjetor 2023'.

127 "Punimet e aktivitetit: Tryezë e Rrumbullakët për Lirinë e Medias dhe Sigurinë e Gazetarëve në Shqipëri," aksesuar më 30 korrik 2024.

128 Diskutime në panel për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve të organizuar nga [Faktoje.al](#), [Cluster 1](#), [SCiDEV](#), [RsF](#) dhe [AMC](#), [BIRN](#) dhe [SCiDEV](#).

129 "Punimet e aktivitetit: Tryezë e Rrumbullakët për Lirinë e Medias dhe Sigurinë e Gazetarëve në Shqipëri," aksesuar më 30 korrik 2024.

130 IREX. 2023. "Barometri i informimit aktiv: Shqipëria," aksesuar më 23 maj 2024.

kontrolluara kryesisht nga një grup i vogël familjesh me ndikim dhe me interesa të caktuara në tregjet e rregulluara.¹³¹ Ky përqendrim i pronësisë shpesh i shtyn mediat t'i shërbejnë programeve politike ose biznesit dhe jo interesit publik. Gazetarët përballen me presion të vazhdueshëm për të shmangur tema të caktuara dhe detyrohen të mbajnë linja të njëanshme editoriale për të qetësuar pronarët, redaktorët dhe politikanët, duke kompromentuar lirinë e shtypit dhe integritetin e gazetarit.¹³² Për më tepër, gazetarët përballen me rreziqe sigurie, përfshirë këtu sulmet fizike dhe kërcënimet, veçanërisht gjatë krizave si protesta apo fatkeqësi natyrore, ku masat për sigurinë e tyre janë të papërshtatshme dhe mbështetja nga agjencitë e zbatimit të ligjit është e vogël, të cilat e përkeqësojnë edhe më shumë problemin.

Nga ana tjetër, mediat online ofrojnë një peizazh më të larmishëm me pavarësi më të madhe editoriale. Shumë prej tyre janë biznese të reja të drejtuara nga gazetarë profesionistë të përkushtuar ndaj integritetit dhe pavarësisë, duke ofruar kështu mundësi për raportim nga këndvështrime të ndryshme larg ndikimeve të panevojshme. Megjithatë, mediat online përballen me sfida të ndryshme, si qëndrueshmëria financiare dhe kërcënimet për sigurinë dixhitale, pavarësisht se ofrojnë mbrojtje nga kufizimet me të cilat përballen mediat tradicionale. Gjithsesi, një numër i konsiderueshëm i mediave online nuk kanë gazetarë në terren, duke u mbështetur kështu tek burimet dytësore. Kjo nxjerr në pah mangësitë në raportimin origjinal dhe gazetarinë investigative.¹³³ Po ashtu, shumë artikuj op-ed (kryeartikuj) në mediat online janë me burim nga faqet e mediave sociale të autorëve pa cituar autorin apo pa e njoftuar atë, duke ngritur shqetësime për etikën lidhur me transparencën dhe njohjen e të drejtave të autorit. Mungon vazhdimisht qëndrueshmëria në ofrimin e citimeve dhe lidhjeve online tek artikujt, gjë që është me rëndësi të madhe për transparencën dhe për t'i bërë të mundur lexuesve të verifikojnë informacionin.¹³⁴ Mungesa e citimeve dhe lidhjeve përkatëse online është problem madhor për sa i përket të drejtave të autorit dhe ngre shqetësime për standardet etike të këtyre mediave. Në respektimin e këtyre praktikave etike kryesojnë OJQ-të dhe mediat ndërkombëtare, ndërsa mediat online i respektojnë deri në një farë mase praktikatat e citimeve, por shumë pak ato për lidhjet online tek artikujt origjinalë.¹³⁵

— B.6 POZICIONI EKONOMIK I GRAVE GAZETARE

Në Shqipëri, gratë gazetare përballen me vështirësi të mëdha në vendin e punës, si diskriminimi me bazë gjinore, ngacmimi seksual, dhuna online dhe disinformimi me motiv gjinor.¹³⁶ Frika nga hakmarrja dhe riviktimizimi shpesh bëjnë që këto probleme të mos raportohen mjaftueshëm. Është me rëndësi të madhe të rritet mbështetja dhe të shtohen masat

131 Këtë e konfirmojnë raporte të shumta: [MOMA 2023](#), [Liria në Botë 2023](#), [Treguesi i Shtypit të Lirë 2023](#), [SCIDEV Raporti Hije 2024](#), [NIS 2023](#).

132 [Intervistë me Kryetarin e Këshillit Shqiptar të Medias](#), korrik 2024.

133 Intervistë e thelluar me gazetar uebi, 3 prill 2024.

134 Këshilli Shqiptar i Medias. 2024. [Mediat online në Shqipëri](#), aksesuar më 4 gusht 2024.

135 Këshilli Shqiptar i Medias. 2024. [Mediat online në Shqipëri](#), aksesuar më 4 gusht 2024.

136 IDM. 2023. 2023. [Studim: Liria për të mbrojtur të drejtat në hapësirat online: Sfida për gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut në Shqipëri](#), aksesuar më 31 maj 2024.

mbrojtëse, përfshirë këtu mekanizma efikasë të raportimit dhe hapat për të luftuar diskriminimin dhe ngacmimin. Nga ana tjetër, gratë janë të nënpërfaqësuar në rolet drejtuese brenda mediave, por mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë pengon evidentimin e progresit. Përveç kësaj, hendeku gjinor në paga pengon fuqizimin e tyre ekonomik dhe perspektivat për role e poste drejtuese. Problematikat lidhur me ngacmimet seksuale të paraportuara, dhunën online dhe fushatat e shpifjes janë presione të përhapura që pengojnë zhvillimin e karrierës dhe pjesëmarrjen e grave gazetare.¹³⁷

Edhe pse gratë përfaqësojnë shumicën e gazetarëve në Shqipëri, ato shpesh janë të nënpërfaqësuar në poste drejtuese në redaksi.¹³⁸ Ky hendek gjinor është i pranishëm edhe në nivelet e vendimmarrjes në media¹³⁹ dhe shkakton mungesën e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Pa të dhëna të sakta, është e vështirë të matet progresi dhe të identifikohen fushat që kanë nevojë për më shumë vëmendje dhe burime. Kjo mungesë të dhënash e bën mjaft të vështirë gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme dhe zbatimin e politikave dhe programeve që synojnë të trajtojnë diskriminimin me bazë gjinore dhe të promovojnë barazinë gjinore në sektorin e medias.

137 Diskutime në panel për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve të organizuar nga [Faktoje.al](#), [Cluster 1](#), [SCiDEV](#), [RsF](#) dhe [AMC](#), [BIRN](#) dhe [SCiDEV](#).

138 Referuar të dhënave nga [Monitorimi i pronësisë së mediave në Shqipëri 2023](#), nga 8 media shtypi, vetëm revista Monitor ka një grua kryeredaktore; nga 12 mediat e mëdha audiovizive, vetëm 3 kanë grua si kryeredaktore.

139 [Struktura pronësore e mediave audiovizive](#) e publikuar në vitin 2024 nga AMA dhe [Monitorimi i Pronësisë së Mediave Shqipëri 2023](#) nga BIRN Albania tregojnë se shumica e aksionerëve dhe vendimmarrësve janë burra.

C. SIGURIA E GAZETARËVE

— C.1 GAZETARËT DHE PUNONJËSIT E MEDIAS KANË AKSES TE MASAT E MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE MBROJTËSE KUR NDJEHEN TË KËRCËNUAR

Në vitin 2023, Shqipëria nuk bëri asnjë përparim lidhur me krijimin e mekanizmave të posaçëm për raportimin e gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve serioze për jetën.¹⁴⁰ Institucionet shtetërore nuk kanë ofruar kanale të veçanta denoncimi për individët, përfshirë këtu gazetarët dhe punonjësit e medias. Edhe pse ekziston një numër unik pa pagesë i urgjencës (112) i menaxhuar nga Ministria e Brendshme për situata emergjente, ai nuk është i përshtatur për denoncimin e gjuhës së urrejtjes apo kërcënimeve që kanë një objektiv të caktuar dhe nuk i plotëson nevojat unike të gazetarëve. Përveç kësaj, nuk është krijuar asnjë linjë telefonike e posaçme për gjuhën e urrejtjes. Në vitin 2023 Policia e Shtetit ndërmori nisma për ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit për gjuhën e urrejtjes përmes projekteve të financuara nga donatorët, por këto projekte nuk përfshijnë krijimin e mekanizmave të denoncimeve të drejtpërdrejta. Duhet theksuar se edhe sikur të krijoheshin struktura apo mekanizma të tillë, varësia e tyre nga një ekzekutiv i karakterizuar nga një centralizim i fortë – dhe shpesh i konsideruar si censor i medias – do të ngrinte shqetësime për paanshmërinë dhe efektivitetin e tyre.

Edhe ndihma juridike mbetet problem, duke pasur parasysh se legjislacioni¹⁴¹ në fuqi nuk i përfshin gazetarët apo punonjësit e medias në kategorinë e njerëzve që përfitojnë ndihmë juridike falas të garantuar nga shteti ose që të përjashtohen nga tarifatat gjyqësore, duke bërë kështu që ata të mbeten pa shërbime të specializuara juridike shtetërore. Disa OJQ ofrojnë mbështetje ligjore për gazetarët sipas projekteve të financuara nga donatorët, por kësaj qasjeje i mungon qëndrueshmëria afatgjate.¹⁴²

Policia ka qenë përgjithësisht e shpejtë në regjistrimin e denoncimeve për kërcënime të gazetarëve, por ka mangësi të theksuara në kryerjen e hetimeve të plota, veçanërisht lidhur me sulmet online dhe gjuhën e urrejtjes. Intervistat dhe raportet sugjerojnë se procedurat e mëpasshme, si hetimet e kryera nga prokurorët dhe dënimi i autorëve, shpesh janë të ngadalta dhe joefikase.¹⁴³ Pavarësisht se institucionet shtetërore përpunojnë raporte për shkeljen e të drejtave, strukturat, burimet dhe kapacitetet e kufizuara shpesh çojnë në reagim të pamjaftueshëm dhe të paefektshëm, veçanërisht në trajtimin e kërcënimeve, ngacmimeve online, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit me bazë gjinore ndaj gazetarëve. Shumë raste ose pushohen ose vonohen për shkak të provave të pamjaftueshme, gjë që tregon një kuadër të dobët institucional dhe që ul efektivitetin e hetimeve gjithëpërfshirëse.

140 Në vitin 2024, në kuadër të një [projekti me OSBE-në](#) në Ministrinë e Brendshme u caktua një person i posaçëm kontakti për sulmet ndaj gazetarëve.

141 Ligji Nr. 111/2017

142 [Qendra Respublica, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, MFRR](#)

143 Diskutime në fokus grupe, 5 2024.

Për më tepër, raportimi fare i pakët i rasteve të tilla nga gazetarët tek autoritetet shtetërore është shqetësues.¹⁴⁴ Mungesa e të dhënave apo statistikave më të fundit për statusin e hetimeve lidhur me sulmet ndaj gazetarëve e përkeqëson edhe më tej këtë problem. Informacioni për hetimet në vazhdim shpesh trajtohet si konfidencial ose fshihet me pretekstin e sekretit hetimor pa qenë nevoja, duke i mohuar viktimës (gazetarëve) të drejtat e parashikuara në Nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale dhe duke dëmtuar aftësinë për të monitoruar nga jashtë ecurinë e këtyre rasteve.

— C.2 GAZETARËT DHE PUNONJËSIT E MEDIAVE (JETA OSE INTEGRITETI FIZIK I TË CILËVE ËSHTË NË RREZIK REAL DHE TË MENJËHERSHËM) KANË AKSES TE MEKANIZMA TË POSAÇËM MBROJTJEJE APO SIGURIE

Në legjislacionin në fuqi në Shqipëri mungojnë garancitë dhe mekanizmat e posaçëm mbrojtës për sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias në rast se përballen me rreziqe. Mekanizmat ekzistues, si mekanizmi për mbrojtjen e viktimave, nuk janë të projektuar për të trajtuar nevojat dhe sfidat specifike me të cilat përballen gazetarët. Të dhënat e mbledhura për këtë raport tregojnë se në vitin 2023 nuk është regjistruar asnjë rast ku gazetarët të kenë përfituar nga mekanizmi i mbrojtjes së viktimave.¹⁴⁵ Megjithatë, ekzistojnë forma alternative mbështetjeje në dispozicion të gazetarëve, si ndihma pro-bono apo asistencë ligjore, e ofruar nga organizata të shoqërisë civile në vend dhe ato ndërkombëtare dhe avokatët e lirisë së medias. Këto janë disa nga format e ndihmës dhe mbrojtjes që u ofrohet gazetarëve për kapërcimin e sfidave ligjore dhe garantimin e sigurisë së tyre. Gjithsesi, është ende e nevojshme të krijohen mekanizma sigurie të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura që të trajtojnë në mënyrë specifike rreziqet unike me të cilat përballen gazetarët dhe punonjësit e medias në Shqipëri.

Të dhënat e mbledhura për këtë raport tregojnë qartazi se autoriteteve shtetërore në Shqipëri u mungojnë procedurat sistematike dhe të mirë-integruara për vlerësimin e rreziqeve me të cilat përballen gazetarët dhe punonjësit e medias.¹⁴⁶ Kjo mungesë përbën një hendek të madh lidhur me masat e nevojshme për vlerësimin dhe trajtimin e shqetësimeve që lidhen me sigurinë e punonjësve në industrinë e medias. Nevoja për të hartuar dhe vënë në zbatim protokolle të posaçme që i japin përparësi vlerësimit të rrezikut që cenon gazetarët dhe punonjësit e medias është më se e evidente, pasi me praktikatat aktuale dhe normat kulturore të autoriteteve shtetërore këto probleme nuk trajtohen siç duhet.

Për më tepër, mekanizmat e parashikuar në ligj për mbrojtjen dhe sigurinë e viktimave nuk janë krijuar për të përmbushur nevojat unike të gazetarëve, gjë që çon në mangësi të konsiderueshme lidhur me mbrojtjen dhe mundësi të kufizuara

144 "Punimet e aktivitetit: Tryezë e Rrumbullakët për Lirinë e Medias dhe Sigurinë e Gazetarëve në Shqipëri," aksesuar më 30 korrik 2024.

145 Kërkesë për informacion, përgjigja erdhi më 15 janar 2024.

146 Diskutim në fokus grup dhe intervistë e thelluar.

për zhvendosjen e tyre brenda vendit. Shoqëria civile me nismat e saj është përpjekur të rrisë sigurinë e gazetarëve, por këto përpjekje nuk mund të kompensojnë plotësisht mungesën e masave përkatëse nga shteti. Qendra Respublica¹⁴⁷ ka vënë në dispozicion të gazetarëve një linjë të dedikuar në WhatsApp, ku këta të fundit kanë tashmë mundësinë të këshillohen në kohë reale për të luftuar disinformimin/ keqinformimin dhe për të siguruar mbrojtje ndaj institucioneve.

— C.3 GRATË GAZETARE KANË AKSES TE MASAT LIGJORE DHE MEKANIZMA MBËSHTETJEJE KUR PËRBALLEN ME KËRCËNIME, NGACMIME DHE DHUNË ME BAZË GJINORE

Edhe pse Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e Stambollit dhe i raporton Këshillit të Evropës rregullisht për të, zbatimi i plotë dhe efektiv i Konventës është ende problem. Një çështje problematike është mungesa e të dhënave të ndara në mënyrë të veçantë për rastet që përfshijnë gratë gazetare që bien pre e dhunës, kërcënimeve ose ngacmimeve seksuale.¹⁴⁸ Kjo mungesë të dhënash specifike mund të çojë në një mosvlerësim të seriozitetit të problemit nga autoritetet përgjegjëse për trajtimin e këtyre çështjeve.

Mekanizmat mbështetës në fuqi të krijuar kryesisht për viktimat e dhunës në familje me bazë gjinore jo vetëm që janë të fragmentuara dhe me burime të pamjaftueshme, por as nuk arrijnë të përmbushin nevojat specifike të grave gazetare, të cilat përballen me vështirësi dhe kërcënime unike në mjedisin e tyre të punës. Veçanërisht shqetësues është ngacmimi seksual. Gratë gazetare shpesh hezitojnë të denoncojnë incidente të tilla dhe institucionet përgjegjëse për trajtimin e këtyre denoncimeve në shumë raste nuk kanë kapacitetin e duhur për t'i trajtuar ato me efikasitet.

Ndihma juridike falas e garantuar nga shteti ofrohet për viktimat e dhunës në familje, ngacmimit seksual dhe trafikimit të qenieve njerëzore, por nuk ka dispozita ligjore të posaçme për gratë gazetare si përfituese të drejtpërdrejta të këtyre shërbimeve. Duhet bërë përpjekje për të siguruar që gratë gazetare të marrin ndihmën e nevojshme ligjore dhe t'u ofrohen mekanizmat mbrojtës të përshtatura për nevojat dhe sfidat e tyre unike.

Shqipëria nuk ka një sistem të unifikuar që të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë këtu masat e sigurisë dhe këshillimin ligjor. Shërbimet ekzistuese janë të fragmentuara, duke i detyruar viktimat të sorollaten nga njëri institucion në tjetrin, gjë që mund të kontribuojë në riviktimizimin e tyre. Për shembull, ndonëse Neni 58/1/d i Kodit të Procedurës Penale i jep të drejtën viktimës të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, marrja e një informacion të tillë shpesh kufizohet në mënyrë të pajustificueshme nga prokuroria gjatë fazës së hetimit nën maskën e sekretit hetimor.

147 [Hotline për këshillim dhe mbështetje ligjore të gazetarëve.](#)

148 Kërkesa për informacion konfirmon mungesën e të dhënave të ndara.

Shërbimet sociale vendore, shpesh në partneritet me OJQ-të, ofrojnë një farë mbështetjeje për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe ato të dhunës në familje përmes mekanizmave referues vendorë në nivel bashkie. Kjo mbështetje është kryesisht për trajtimin e dhunës në familje dhe mund ka mangësi për sa i përket burimeve dhe trajnimeve për të mbështetur në mënyrë të veçantë gratë gazetare. Kjo mund të sjellë si rezultat mbështetje dhe këshilla të papërshtatshme profesionale për gratë gazetare që përballen me kërcënime dhe ngacmime me bazë gjinore.

Gratë gazetare në Shqipëri vazhdojnë të përballen me raste të ngacmimeve seksuale, dhunë online dhe fushata të shpifjes si format më të zakonshme të presioneve me bazë gjinore që u bëhen. Këto presione shpesh nuk raportohen, sepse shumë gazetare mendojnë se denoncimet e tyre nuk do të merren seriozisht ose se do të përballen me hakmarrje në rast se flasin hapur. Për më tepër, ka shqetësime në rritje për disinformimin gjinor dhe dhunën online ndaj grave gazetare. Këto të fundit kanë raportuar se kanë marrë një numër më të madh komenteve mizogjene dhe kërcënuese në platformat e mediave sociale, ku disa komente janë shprehimisht të dhunshme ose seksuale për nga natyra.¹⁴⁹ Ky lloj ngacmimi dhe disinformimi në internet mund të dëmtojë veçanërisht karrierën e tyre, pasi mund t'i dekurajojë ato në ndjekjen e historive të caktuara ose në marrjen përsipër të roleve të caktuara në industrinë e medias. Në Shqipëri, gratë gazetare kanë mundësinë të kërkojnë ndihmë nga institucionet shtetërore si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe mund t'i denoncojnë në polici rastet e diskriminimit dhe ngacmimit me bazë gjinore.

— C.4 PRAKTIKA E RREGULLT E DËNIMIT PUBLIKISHT TË KËRCËNIMEVE DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE ËSHTË KRIJUAR

Në Shqipëri, praktika e dënimit publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të medias është e paqëndrueshme, me hope dhe shpesh e ndikuar nga interesat politike. Ndonëse disa autoritete publike i kanë denoncuar këto sulme si shkelje të lirisë së shprehjes, përgjigjeve të tyre në përgjithësi u mungojnë veprimet konkrete për zgjidhjen e problemeve madhore. Me raste, policia i përgjigjet publikisht dhe me shpejtësi sulmeve të tilla, por hetimet e mëpasshme janë zakonisht të kufizuara, jo gjithëpërfshirëse dhe të vonuara. Nga ana tjetër, ka një problem të vazhdueshëm me mosndëshkimin e atyre që ushtrojnë dhunë ndaj gazetarëve, problem që shoqërohet nga mungesa e mbledhjes sistematike e të dhënave për sulme të tilla. Për të rritur sigurinë e gazetarëve dhe për të mbrojtur në mënyrë efektive lirinë e shtypit, është me rëndësi tejet të madhe të krijohet një qasje më e qëndrueshme, koherente dhe e institucionalizuar lidhur me dënimin publik, mbështetur me procese që i çojnë hetimet deri në fund dhe me masa që i vënë autorët para përgjegjësisë.

149 IDM. 2023. 2023. [Studim: Liria për të mbrojtur të drejtat në hapësirat online: Sfida për gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut në Shqipëri](#), aksesuar më 31 maj 2024.

Dënimi publik i kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në Shqipëri është i ndikuar shumë nga dinamikat politike, duke çuar në reagime të ndryshme nga politikanët me ndikim dhe partitë politike. Partia Demokratike, si partia kryesore e opozitës, shpesh dënon me forcë incidente të tilla, duke ia atribuar gërryerjen e lirisë së medias Partisë Socialiste në pushtet. Si për kontrast, zyrtarë të rangut të lartë të Partisë Socialiste dhe personazhe publike të lidhur me të zakonisht i minimizojnë këto incidente. Kjo qasje partiake nënvizon politizimin e çështjeve të lirisë së medias dhe ndërlikon përpjekjet për të krijuar një qëndrim të unifikuar dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen e gazetarëve. Për të nxitur një klimë të vërtetë të lirisë së shtypit dhe për të mbrojtur të drejtat e gazetarëve, është e domosdoshme që udhëheqësit politikë të të gjithë kaheve t'i japin përparësi sigurisë dhe mirëqenies së gazetarëve, duke dënuar pa mëdyshje dhe pavarësisht përkatësive politike kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve

Në korrik 2023, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt dënoi ashpër sulmin verbal të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ndaj gazetares Ola Xama të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative (BIRN) Albania, pas raportit investigativ të kësaj të fundit për një rast korrupsioni ku përfshiheshin politikanë dhe zyrtarë publikë të nivelit të lartë. Pas publikimit të shkrimit të datës 13 korrik, ku detajohej një hetim nga SPAK për një skandal me incenerator dhe ku përmendej ndër të tjera edhe kryebashkiaku Veliaj, ai refuzoi të komentonte përpara publikimit dhe më pas sulmoi zonjën Xama përmes WhatsApp, duke e etiketuar atë si "vrasëse me pagesë".¹⁵⁰ Ky sulm personal, i bërë jehonë nga retorika të ngjashme nga media të tjera, përkeqëson mjedisin tashmë armiqësor për gazetarët dhe nënvizon shqetësimet e mëdha lidhur me lirinë e shtypit dhe debatin publik në Shqipëri.

Më 23 tetor 2023, BIRN Albania botoi një artikull investigativ ku detajon akuzat për korrupsion që përfshinin ish-kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha dhe dhëndrin e tij, Jamarbër Malltezi, duke cituar dokumentet e SPAK që akuzonin Malltezin për krijimin e një pasurie përmes marrëveshjeve të fshehta dhe favoreve politike. Të nesërmen, Berisha denoncoi BIRN Albania në një konferencë shtypi, duke shënuar një tjetër sulm në fushatën e tij të vazhdueshme kundër medias, të cilën ai e akuzon se është ndikuar nga financues të jashtëm, si Xhorxh Soros, për të diskredituar opozitën. Në të njëjtën kohë, BIRN Albania u përball me shpifje nga portalet anonime online si Prapaskena.al, duke e akuzuar për paragjykime politike pas publikimit të tyre "Drejtësi apo hakmarrje? "Ish-i forti i Shqipërisë" lufton me akuzat për korrupsion" Kjo armiqësi e shumanshme e vendos BIRN Albania në një pozitë të vështirë, të akuzuar si nga mbështetësit e qeverisë ashtu edhe nga opozita, duke ilustruar mjedisin kompleks për median e pavarur në Shqipëri. Përpjekje të tilla kërcënimi dhe diskreditimi janë alarmante, pasi dëmtojnë integritetin e gazetarisë. Situata u përshkallëzua më 13 nëntor 2023, kur avokati i Malltezit lëshoi një denoncim publik ndaj BIRN, duke i akuzuar ata për shpifje

150 [Njoftim i Rrjetit të Gazetarëve të Sigurt](#), korrik 2023.

ndaj Berishës dhe familjes së tij, gjë që përforcoi më tej fushatën e ndërmarrë për minimin e besueshmërisë së BIRN Albania.¹⁵¹

— C.5 ORGANET E POLICISË JANË TË NDJESHME NDAJ ÇËSHTJES SË MBROJTJES SË GAZETARËVE

Gjatë vitit të kaluar oficerë të policisë dhe gjyqtarë morën pjesë në trajnime të financuara nga donatorë ndërkombëtarë,¹⁵² ku trajtoheshin tematika si siguria e gazetarëve, siguria në internet, gjuha e urrejtjes dhe ngacmimi.¹⁵³ Ndonëse këto nisma ishin të dobishme, nevoja është sërish e madhe për rritje të mëtejshme të kapaciteteve dhe shtimin e përpjekjeve për rritje të ndërgjegjësimit me qëllim që të kuptohen dhe zbatohen më mirë praktikrat më të mira në marrëdhëniet dhe procedurat me gazetarët. Nuk ka protokolle të posaçme të miratuara nga organet e policisë apo institucione të tjera publike për ndalimin e ngacmimeve, kërcënimit apo sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Këshilli i Evropës po mbështet Policinë e Shtetit për të hartuar protokolle të tilla në vitin 2024.

Në vitin 2023 nuk u raportua asnjë rast i ndalimit të pabazë të gazetarëve nga Policia. Sipas të dhënave nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, incidentet e vitit 2022 nxorën në pah shqetësimet për trajtimin e gazetarëve nga punonjësit e policisë në Shqipëri. Për shembull, gazetari Sami Curri u shoqërua në komisariat teksa mbulonte një protestë kundër rritjes së çmimeve, ndërsa fotografit Gent Shkullaku iu konfiskua aparati gjatë përplasjeve me tifozët e futbollit. Gazetarët që mbulonin protestat u përballën me shënjestrimin e policisë, me dy të sulmuar fizikisht në Tiranë dhe Durrës. Gazetari Ledio Guni u largua me forcë nga policia teksa dokumentonte shembjet e shtëpive në lagjen "5 Maji" të Tiranës dhe gazetarja Sonila Musai u tërhoq zvarrë nga policia ndërkohë që raportonte për qëndresën e banorëve kundër prishjes së banesave. Çështja e Sonila Musait po përfaqësohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH). Megjithatë, edhe pas dy vitesh, rasti ende nuk është hetuar plotësisht.¹⁵⁴ Këto incidente nënvizojnë nevojën për hetime efikase dhe të shpejta, brenda mundësive, përfshirë këtu trajtimin e ndalimit të pajustificuar dhe keqtrajtimin e gazetarëve me qëllim që të garantohet siguria e tyre në vend.

Në vitin 2023, ka pasur një rritje të dukshme të dënimit publik nga zyrtarët shtetërorë të sulmeve ndaj sigurisë së gazetarëve, duke i etiketuar ato si shkelje të lirisë së shprehjes.¹⁵⁵ Policia ka treguar një rritje të reagimit në trajtimin publik të këtyre incidenteve. Megjithatë, vazhdojnë të ketë kufizime në kryerjen e hetimeve administrative efikase nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave dhe ndjekjen penale nga Prokuroria. Institucionet e pavarura, përfshirë këtu Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisionerin për Mbrojtjen e Informacionit

151 [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt](#), tetor 2023.

152 [Projekti i Këshillit të Evropës në Shqipëri](#).

153 [Manual për forcat e zbatimit të ligjit](#)

154 Në vitin 2023, Gjykata e Apelit Tiranë rrëzoi ankimimin e Prokurorisë së Shkallës së Parë, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në të cilën kërkohej që prokuroria të vazhdonte hetimin e çështjes. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme, duke i caktuar prokurorisë detyra specifike. 2023-AHC-Report-on-Human-Rights_-002.pdf, [Raport krahasimor mbi situatën e respektimit të të drejtave dhe lirisë të njeriut në Shqipëri për vitet 2022 – 2023, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, fq. 36](#)

155 [Njoftime të Rrjetit të Gazetarëve të Sigurt për 2023](#).

dhe të Dhënave, kanë bashkëpunuar me organizatat e gazetarëve për të trajtuar problemet me sigurinë e tyre. Është për t'u theksuar se Prokuroria e Përgjithshme dhe Policia janë angazhuar në bashkëpunim edhe me organizatat e gazetarëve për çështjet e sigurisë së gazetarëve.

— C.6 NJËSITË/OFFICERËT QË MBULOJNË HETIMET E SPECIALIZUARA JANË TË PAJISUR ME EKSPERTIZËN PËRKATËSE PËR HETIMIN E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE

Sistemit të drejtësisë në Shqipëri i mungojnë njësitë e specializuara të dedikuara për hetimin dhe ndjekjen penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve. Edhe pse ka pasur nisma trajnime për të përmirësuar njohuritë dhe ndërgjegjësimin tek agjencitë e zbatimit të ligjit, këto të fundit ende nuk i kanë burimet e nevojshme për të hetuar në mënyrë efektive sulmet dhe dhunën me objekt gazetarët. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka ndërmarrë hapa për rishikimin dhe përfshirjen e ndryshimeve në Procedurën Standarde të Veprimit të titulluar "Planifikimi i shërbimeve të policisë gjatë tubimeve".¹⁵⁶ Kjo procedurë tani përfshin një dispozitë të veçantë që përshkruan masat që duhet të zbatojë Policia e Shtetit për të siguruar dhe përforcuar praninë e gazetarëve dhe përfaqësuesve të tjerë të medias në tubime. Në të theksohet edhe mbrojtja e të drejtës së gazetarëve për të raportuar dhe informuar publikun, së bashku me dhënien e mbrojtjes kundër çdo kundërshtimi ose sulmi me të cilin mund të përballen gazetarët gjatë kryerjes së detyrave të tyre ose për shkak të detyrimeve të tyre profesionale.¹⁵⁷

Edhe pse disa institucione shtetërore kanë marrë trajnime për trajtimin e gazetarëve dhe punonjësve të medias, miratimi i protokolleve zyrtare prej tyre është në nivele të kufizuara. Policia dhe prokurorët kanë njohuritë bazë për veprat penale që lidhen me dhunën dhe sulmet ndaj gazetarëve, por atyre u duhet të zhvillojnë më tej dhe të zbatojnë protokolle gjithëpërfshirëse për t'i trajtuar këto çështje deri në fund. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme dhe rritja e aftësive të agjencive të zbatimit të ligjit për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të tilla, si dhe krijimi i praktikës pozitive gjyqësore në drejtim të hetimeve të plota, objektive dhe gjithëpërfshirës janë me rëndësi të madhe për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e gazetarëve në vend.

Bashkëpunimi mes institucioneve përkatëse në Shqipëri lidhur me hetimet është i ulët, ndërkohë që vihet re një mungesë e theksuar e një protokollit të posaçëm për gazetarët. Kjo do të thotë se nuk ka udhëzime të përcaktuara ose procedura të standardizuara të përshtatura posaçërisht për trajtimin e sfidave dhe rreziqeve unike me të cilat përballen gazetarët gjatë punës së tyre. Si rezultat, hetimeve dhe përgjigjeve ndaj kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve u mungon qasja sistematike dhe e koordinuar mes institucioneve.

¹⁵⁶ Sanksionuar me Urdhrin nr. 1364, datë 17.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

¹⁵⁷ Këto shtesa janë miratuar me Urdhrin nr. 1180, datë 16.08.2023, me titull "Për miratimin e procedurës standarde të punës për planifikimin e shërbimeve policore gjatë zhvillimit të tubimeve", të lëshuar nga Policia e Shtetit.

— C.7 HETIMET PËR SULME TË RËNDA FIZIKE NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN NË MËNYRË EFIKASE (TË PAVARUR, TË PLOTË DHE TË MENJËHERSHME)

Ashtu si në vitet e mëparshme, në këtë raport vihet në dukje një tendencë shqetësuese me raste të pazgjidhura lidhur me sulmet aktuale ndaj gazetarëve në tre vitet e fundit, duke nxjerrë në pak mungesën e hetimit të duhur dhe afatet e zgjatura për rastet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Është e rëndësishme të theksohet se marrja e informacionit lidhur me hetimet në proces mund të jetë e vështirë për shkak të parimit të fshehtësisë që përdoret në këto procedurë, duke kufizuar kështu marrjen e dosjes së hetimit nga prokurorët dhe policia.¹⁵⁸

Në raport theksohen mangësitë dhe vonesat në hetimin e rasteve të rënda të sulmeve fizike kundër gazetarëve gjatë pesë viteve të fundit. Mungesa e dispozitave të veçanta në Kodin Penal për mbrojtjen e gazetarëve nga dhuna apo sulmet kundër tyre për shkak të detyrës dhe profesionit ka rezultuar në mungesë prioritizimi nga ana e prokurorëve. Dështimi për të hetuar tërësisht motivet e këtyre krimeve përjetëson heshtjen institucionale, duke mohuar të vërtetën për publikun dhe duke penguar ngritjen e akuzave ndaj autorëve dhe/ose ndëshkimin penal të tyre. Sipas të dhënave statistikore për vitin 2023, gazetarët kanë depozituar gjashtë padi penale për shkak të detyrës në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Për këto raste prokurorët e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm kanë nisur procedimin penal. Katër procedime janë aktualisht në hetim, ndërsa dy raste janë dërguar për gjykim. Një rast ka të bëjë me akuzat e nenit 237 të Kodit Penal, "Sulm për shkak të detyrës", ndaj dy të pandehurve të akuzuar për sulm ndaj gazetarit. Një rast tjetër përfshin akuzat sipas nenit 237, "Sulm për shkak të detyrës", nenit 150, "Shkatërrimi i pronës" dhe nenit 110, "Arrestimi i paligjshëm", ndaj një të pandehuri. Është e rëndësishme të theksohet se raporti vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme për kriminalitetin në vend, edhe në vitin 2023, nuk jep të dhëna publike për veprat penale që përfshijnë gazetarët si viktimat, përfshirë këtu edhe rastet e sulmeve të rënda fizike ndaj tyre.¹⁵⁹

Raporte të shumta tregojnë se hetimi i sulmeve ndaj gazetarëve pengohet nga ndërçori me afatet procedurale, të cilat zgjaten ndjeshëm përtej periudhës së zakonshme 3-mujore nga prokuroria si dhe mungesa e burimeve dhe kapaciteteve të policisë por edhe të prokurorisë. Kjo situatë ngre shqetësime për prioritizimin e këtyre rasteve, pasi burimet e kufizuara të akorduara për hetimin e sulmeve ndaj gazetarëve është tregues se hetimi i rasteve të tilla nuk merret përherë me përparësi. Vonesat që rezultojnë dhe kufizimet e burimeve minojnë efektivitetin e hetimeve dhe pengojnë vendosjen e drejtësisë për viktimat e këtyre sulmeve.

158 Për shembull, sulmi i armatosur në [Top Channel](#) nuk është zgjidhur ende; as sulmi fizik ndaj [Ervis Hilës](#).

159 [Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2023](#)

— C.8 GAZETARËT DHE PUNONJËSIT E TJERË TË MEDIAVE MBROHEN ME EFIKASITETET NGA FORMAT E NDRYSHME TË NGACMIMEVE ONLINE

Kuadri ligjor në Shqipëri e trajton mbrojtjen nga ngacmimi në disa ligje të ndryshme, secili me përkufizimin e tij specifik. Neni 108/a i Kodit Penal fokusohet te ngacmimi seksual, ku përfshin çdo sjellje që cenon dinjitetin e një personi dhe krijon një mjedis kërcënues ose fyes, përfshirë ngacmimin online. Nga ana tjetër, neni 32/a i Kodit të Punës jep një përkufizim gjithëpërfshirës të ngacmimit në kontekstin e marrëdhënieve të punës, duke theksuar përgjegjësinë e punëdhënësit për të parandaluar ngacmimet seksuale dhe morale dhe sigurimin e kushteve të mira të punës. Nga ana tjetër, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas nenit 3, pika 5, mbron individët nga ngacmimet me bazë diskriminuese, duke synuar mbrojtjen e dinjitetit të tyre dhe sigurimin e një mjedisi respektues. Këto ligje trajtojnë të gjithë së bashku aspekte të ndryshme të ngacmimit, duke përcaktuar përgjegjësi të ndara apo të njëkohshme penale, civile dhe administrative për autorët. Një kuadër i tillë ligjor imponon nevojën për masa proaktive nga punëdhënësit, individët dhe shoqëria për të parandaluar dhe trajtuar sjellje të tilla.

Gazetarët që bëhen objekt i fushatave të shpifjes¹⁶⁰ përballen me dëme të besueshmërisë së tyre profesionale, gjë që nxit mosbesimin e publikut dhe me gjasa rrezikon integritetin e raportimit të tyre. Këto fushata shkaktojnë një barrë të konsiderueshme psikologjike, veçanërisht në kontekste ku mungojnë sistemet mbështetëse. Devijimi i burimeve larg punës investigative për të luftuar fushatat e shpifjeve tensionon edhe më shumë sektorin e mediave tashmë të kufizuar në Shqipëri. Frika për t'u bërë vetë objekt i fushatave të tilla mund të nxisë autocensurën mes gazetarëve, duke mbytur kështu lirinë e shtypit. Rekursi ligjor është mjaft i vështirë për shkak të perceptimeve për paanshmërinë e gjyqësorit, numrit të rasteve të pazgjidhura dhe kostove të larta. Për më tepër, solidariteti dhe mbështetja nga kolegët dhe komuniteti shpesh janë të pamjaftueshme, gjë që e përkeqëson ndikimin e fushatës së shpifjes dhe vë në rrezik burime mjaft të vlefshme.

Gazetarët në Shqipëri përballen me sfida të mëdha, përfshirë aksesin e kufizuar në ndihmën juridike falas dhe te mekanizmat e mbrojtjes, duke i lënë ata të pambrojtur ndaj kërcënimeve dhe dhunës, veçanërisht kur mbulojnë çështje të ndjeshme. Frika nga hakmarrja i pengon shumë gazetarë të kërkojnë drejtësi ose mbrojtje, duke pasur parasysh se ata nuk u besojnë institucioneve dhe kanë frikë nga riviktimizimi. Mediat shpesh refuzojnë të japin mbështetje financiare ose ligjore, duke i detyruar gazetarët të përballen të vetëm në betejat ligjore, gjë që me gjasa çon në censurë ose autocensurë. Këto çështje theksojnë nevojën urgjente për përmirësimin e sistemeve mbështetëse për të mbrojtur të drejtat e gazetarëve dhe për të garantuar lirinë e shtypit.

160 [Rasti Ola Xama](#)

— C.9 HETIMET E TË GJITHA FORMAVE TË SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN NË MËNYRË TRANSPARENTE

Sipas nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, viktimat, përfshirë edhe gazetarët, kanë të drejtë të të kërkojnë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor. Megjithatë, në praktikë, gazetarëve shpesh u hiqet e drejta e për t'u njohur me aktet dhe prova gjatë hetimit, pasi këto të fundit në mjaft raste konsiderohen në mënyrë të pajustificueshme sekret hetimor.

Ligji 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë", parashikon krijimin e pozicioneve të reja në gjykata, përfshirë këtu disa pozicione kyçe për komunikimin me median dhe publikun. Nëpërmjet disa zyrtarëve publikë si Anëtari i Caktuar për Marrëdhëniet me Publikun, Gjyqtarët e Medias dhe Zyrtarët e Medias dhe Marrëdhëniet me Publikun në gjykata, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) siguron që informacioni që i jepet publikut të jetë i saktë dhe në kohë, duke përdorur një shumëllojshmëri mjetesh, përfshirë edhe faqet e internetit. Në vitin 2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor prezantoi planin strategjik të komunikimit për sistemin gjyqësor si dhe emërimin e 16 gjyqtarëve për median në 13 gjykata të rretheve gjyqësore dhe 3 gjykata apeli, duke synuar rritjen e nivelit të informimit dhe transparencës.¹⁶¹

— C.10 AUTORITETET SHETËRORE KRIJOJNË SISTEME CILËSORE TË MBLEDHJES SË STATISTIKAVE PËR T'I DHËNË FUND PANDËSHKUESHMËRISË

Shqipërisë i mungon regjistrimi, analizimi dhe publikimi zyrtar i të dhënave që lidhen veçanërisht me sulmet ndaj gazetarëve dhe mosndëshkimin e autorëve të këtyre sulmeve. Në përgjithësi, institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet e nevojshme për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla. Aktualisht nuk ka të dhëna të ndara në kategori, edhe pse kjo është kërkesë e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës,¹⁶² sipas të cilit Prokuroria e Përgjithshme duhet të publikojë rast pas rasti rezultatet e hetimeve për rastet e sulmeve kundër gazetarëve nga viti 2024 e në vazhdim.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë mbledh dhe përpilon të dhëna për çështjet e gazetarëve që nga viti 2023 e në vazhdim. Gjithashtu, parashikohet që deri në vitin 2024 Policia e Shtetit dhe prokuroria të kenë caktuar një person kontakti brenda strukturës së tyre, që do të përgjigjet për trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe do të sigurojë informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për raste të tilla nga viti 2024 e në vazhdim.

161 [Kontaktet e Gjyqtarëve për Mediat](#), Këshilli i Lartë Gjyqësor

162 [Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës 2023](#).

— C.11 KËRCËNIME DHE NGACMIME JO-FIZIKE

Në vitin 2023, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt regjistroi 5 kërcënime dhe ngacmime jo-fizike (3 ndaj burrave dhe 2 ndaj grave). Edhe pse numri mbetet i njëjtë me atë të vitit 2022, serioziteti i rasteve e përkeqëson gjendjen. Rasti kryesor, ai i identifikimit publik nga kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, i dy individëve që dyshohet se qëndronin pas faqeve të njohura online, Lolita dhe 'Jeta Osh Qef'¹⁶³ gjatë një aktiviteti më 29 mars 2023, ka ngjallur shqetësime për sigurinë e tyre. Faqet në fjalë përfshihen në satirë, parodi dhe raportime nga qytetarët, ndonëse jo gjithmonë në përputhje me standardet e gazetarisë. Përmendja nga Veliaj i lidhjeve familjare dhe kërcënimet për veprime ligjore pa prova konkrete ngre alarmin, veçanërisht pasi shkaktoi sulme verbale dhe kërcënime ndaj këtyre individëve në rrjetet sociale. Kjo lëvizje ngre pyetje etike edhe në lidhje me anonimatit dhe profesionalizmin e medias. Lolita bën satirë me çështje sociale dhe politike dhe ka mbi 230,000 ndjekës, ndërkohë që 'Jeta Osh Qef' krenohet me një komunitet të konsiderueshëm online prej mbi 2 milionë ndjekësish. Praktikrat mediatike të Veliaj kanë tërhequr kritika edhe më parë për kufizimin e aksesit të shtypit dhe vendosjen e kontrollit në shpërndarjen e informacionit.

Në një rast tjetër, në korrik 2023, kryebashkiaku Veliaj sulmoi verbalisht gazetaren Ola Xama,¹⁶⁴ kur kjo e fundit publikoi një artikull investigativ për hetimin e SPAK-ut për çështjen e inceneratorit të Tiranës, pavarësisht se Veliaj i ishte dhënë mundësia për të bërë komentet e tij para publikimit të artikullit. Ai e quajti gazetaren "vrasëse me pagesë" në një mesazh në WhatsApp, duke shkaktuar një mjedis armiqësor të përforcuar nga retorika e ngjashme nga media të tjera. Kjo u pasua nga një fushatë shpifjeje nga mediat online. Sulmet dhe ngacmimet online ishin një tjetër formë e shkeljes së sigurisë së gazetarëve në vitin 2023.¹⁶⁵

| Kategoria | Numri | Përshkrim i shkurtër i rasteve |
|---|--------------------|---|
| Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike Në kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike bëjnë pjesë: – Mbikëqyrje ose ndjekje; – Ngacmim me thirrje telefonike; – Ngacmim arbitrar gjyqësor ose administrativ; – Deklarata agresive nga zyrtarë publikë; – Forma të tjera presioni që mund të vënë në rrezik sigurinë e gazetarëve në vijimin e punës. Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë rrethimin apo bulizmin në mjedisin e punës | 5 (3 burra, 2 gra) | <ul style="list-style-type: none"> – Kërcënimet kundër gazetares Ola Xama Kryetari i Bashkisë Tiranë. – Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i nxori emrin publikisht një gruaje që ai pretendon se drejton faqen satirike në Facebook 'Lolita', duke e akuzuar atë për shantazh ndaj kompanive të autobusëve, pa dhënë prova, dhe duke i përmendur se ka dy fëmijë. – Kryetari i Bashkisë së Tiranës identifikon publikisht administratorët e faqeve satirike në internet, duke shkaktuar shqetësime për sigurinë: JOQ. – Shqetësues është komunikimi i drejtorisë së tatimeve me gazetarin Gjergj Erebara, që mund të interpretohet si një përpjekje për të frikësuar gazetarin. – Gazetari Armand Bajrami raportoi përdorimin e të dhënave të tij nga një person i paautorizuar në Seksionin e Krimin Kibernetik në Drejtorinë e Policisë Vendore në Tiranë. |

163 [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, njoftim](#), mars 2023.

164 [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, njoftim](#), korrik 2023.

165 [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, njoftim](#), tetor 2023.

— C.12 KËRCËNIMET KUNDËR JETËS DHE SIGURISË FIZIKE TË GAZETARËVE

Në tetor 2023, gazetarja Afrovita Hysaj u përball me kërcënime dhe sulme publike nga pronari i stacionit lokal televiziv 6+1 Vlorë TV, ndërsa gazetarë të tjerë denoncuan kërcënime që iu bënë atyre kur raportuan përdhunimin në grup të një vajze në Vlorë në fillim të të njëjtit muaj. Është raportuar edhe një rast tjetër i kërcënimit ndaj sigurisë fizike të një gazetari. Gazetari dhe moderatori Blendi Salaj mori një mesazh kërcënues përmes profilit të tij në rrjetet sociale.¹⁶⁶ Në vitin 2022 ka pasur edhe një rast kërcënimi ndaj sigurisë fizike të një ekipi mediatik ([1 burrë dhe 1 grua](#)) dhe situata ka mbetur pothuajse e pandryshuar. Në vitin 2021, pati edhe një rast të kërcënimeve online me jetë kundër një gazetareje, [Alice Taylor](#), çështje që nuk është zgjidhur ende.

| Kategoria | Numri | Përshkrim i shkurtër i rasteve |
|---|---------------------|---|
| Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve Këtu përshihen: <ul style="list-style-type: none"> – Kërkesa për vrasjen e gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; – Kërkesa për dëmtime fizike kundër gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve. Këto kërcënime mund të: <ul style="list-style-type: none"> – Bëhen drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet palëve të treta; – Dërgohen me komunikim elektronik ose ballë për ballë; – Jenë të drejtpërdrejta ose të nënkuptuara. | 2 (1 burrë, 1 grua) | <ul style="list-style-type: none"> – Blendi Salaj, një gazetar shumë i respektuar, ka komentuar së fundmi disa momente serioze gjatë emisionit “Big Brother VIP2” dhe ka marrë dy mesazhe kërcënuese për sigurinë e tij. – Më 24 tetor 2023, Channel 6+1 Vlorë postoi një status në llogarinë e tyre në Facebook që kishte si objekt të drejtpërdrejtë gazetaren Afrovita Hysaj. Përmbajtja e këtij statusi është tërësisht pa etikë dhe cenon reputacionin dhe profesionalizmin e gazetares. |

— C.13 SULMET AKTUALE

Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt regjistroi 9 sulme të aktuale, ndaj gazetarëve 12 dhe 4 grave gazetare të sulmuar në vitin 2023, numër që mbeti i njëjtë me vitin 2022. Në aspektin pozitiv, çështja e Elvis Hilës u zgjidh dhe autorët u nxorën para drejtësisë. Gazetari Elvis Hila u bë pre e një sulmi fizik bashkë me bashkëshorten pas raportimit nga një proces gjyqësor në Lezhë. Në korrik 2023¹⁶⁷ Gjykata e Lezhës shpalli fajtorë dy persona të akuzuar për sulmin ndaj gazetarit. Po në vitin 2023, ndryshe nga viti 2022, nuk ka pasur ndalime të pabaza nga policia apo sulme të tjera fizike ndaj gazetarëve nga organet policore.

¹⁶⁶ [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, njoftim](#), prill 2024.
¹⁶⁷ [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, njoftim](#), korrik 2023.

| Kategoria | Numri | Përshkrim i shkurtër i rasteve |
|---|------------------------|---|
| Sulme faktike ndaj gazetarëve Llojet e sulmeve faktike mund të jenë dëmtimet fizike ose mendore, rrëmbimet, dhunimi i shtëpisë/zyrave, sekuestrimi i pajisjeve, ndalimi arbitrar, tentativa të dështuara për vrasje, etj. | 9 (12 burra dhe 7 gra) | <ul style="list-style-type: none"> - Persona të paidentifikuar sulmuan rëndë gazetarin Gjergj Zefi duke e goditur me objekte të forta. - Elton Qyno, gazetar i televizionit Ora News, u mor në pyetje për rreth shtatë orë më 13 dhjetor 2023 në Tiranë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) dhe iu kërkua konkretisht të zbulonte burimet e tij të informacionit. - Sulm aktual ndaj gazetarëve nga Garda e Republikës/Kuvendi. Gazetarët që tentonin të ndërvepronin me ministrat dhe deputetët për t'iu bërë pyetje, u penguan nga Garda në oborrin e Kuvendit. - Gjatë seancës plenare, deputeti i Partisë Demokratike, Flamur Noka, goditi me librin e rregullores së Kuvendit kameramanin Parid Dado i kanalit televiziv Vizion Plus. - Disa gazetarë dhe media u sulmuan gjatë tensioneve në mbledhjen e grupit të PD-së nga mbështetësit e Lulzim Bashës. - Në Fier, një qytetar goditi operatorin e kamerës së gazetarit të emisionit investigativ "Stop" duke i thyer celularin gazetarit. - Gazetarët e emisionit investigativ televiziv "Fiks Fare" u sulmuan fizikisht më 8 shkurt teksa filmoin shfrytëzimin e paligjshëm në Lumin Zeze në Nikel të Fushë Krujë, 30 km në veri të Tiranës. - Dy persona sulmuan fizikisht gazetarin e Report Tv, Elvis Hila, dhe bashkëshorten e tij në Lezhë. - Gazetarja Marsi Korreshi dhe ekipi i saj nga SYRI TV u sulmuan gjatë raportimit të një tubimit të Partisë Socialiste në qytetin e Rrogozhinës. |

— C.14 KËRCËNIME DHE SULME NDAJ MEDIAVE DHE SHOQATAVE TË GAZETARËVE

Në vitin 2023, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt regjistroi 9 raste kërcënimesh ndaj mediave dhe organizatave si dhe sulme ndaj mediave dhe organizatave të tyre. Ka një përshkallëzim të lehtë të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj organeve të medias në Shqipëri, me një rritje të numrit të rasteve të raportuara dhe ashpërsim të sulmeve. Gjithsesi, janë zgjidhur vetëm një numër i vogël rastesh, gjë që përbën një tendencë shqetësuese. Krimi i organizuar përbën kërcënim serioz për sigurinë e gazetarëve, që shoqërohet nga mosndëshkimi për këto krime dhe nga përpjekjet e politikës për të diskredituar gazetarët, duke shkaktuar një klimë që nxit sulme të mëtejshme. Një rast i rëndë ishte ai me të shtëna në televizionin kombëtar Top Channel në mars të vitit 2023 ku u vra një roje, çështje që ka mbetur e pazbardhur deri më sot.¹⁶⁸ Forma të tjera sulmesh ndaj mediave ishin dixhitale ku faqet e internetit ranë pre e sulmeve DDoS, si shqiptarja.com. Report TV, apo balkanweb.¹⁶⁹

168 [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, njoftim](#), mars 2023.

169 [Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, njoftim](#), tetor 2023.

| Kategoria | Numri | Përshkrim i shkurtër i rasteve |
|--|-------|---|
| <p>Kërcënime dhe sulme ndaj institucioneve, organizatave të medias dhe shoqatave të mediave dhe gazetarëve</p> <p>Sulme faktike ndaj pronave të organeve dhe organizatave të mediave, personelit të tyre, sekuestrim pajisjes, deklarata agresive nga zyrtarë publikë, etj. Po ashtu, në kërcënime dhe sulme të tilla mund të jenë edhe ato të kategorive të mësipërme.</p> | 9 | <ul style="list-style-type: none"> - Në Top Channel ndodhi një ngjarje tragjike. Persona të paidentifikuar hapën zjarr në ambientet e Top Channel në Mzezë, ku për pasojë gjeti vdekjen roja i sigurimit, 60-vjeçari Pal Kola. - Berisha akuzoi BIRN Albania për shpifje dhe njollosje të qëndrimit të tyre moral. - Shqiptarja.com dhe Report TV u bënë objekt i një sulmi kibernetik nga hakerat rusë. - Hakerë të paidentifikuar sulmuan portalin e njohur online, Balkanweb, duke e bllokuar faqen për mijëra lexues brenda dhe jashtë vendit për disa orë. - Ish kryeministri Berisha kërcënoi median BIRN Albania. - Mediat kanë raportuar se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në Shqipëri ka vendosur gjoba për dy stacione televizive, News24, dhe RTV Ora News. - Më 29 nëntor 2023 u mbajt një ceremoni përkujtimore në Varrezat e Dëshmorëve ku nderohen të rënët. Gjatë ceremonisë, Garda e Republikës pengoi praninë e mediave dhe gazetarëve në këtë ngjarje. - Reporteres Arboja Cibuku dhe ekipit të saj iu mohua ndjekja e një aktiviteti nga disa zyrtarë të Bashkisë Tiranë - Gazetari Ronald Qema nga media lokale "Nyje" iu mohua kategorikisht hyrja dhe ndjekja e në takimin e Këshillit Bashkiak të Kamzës. |



Përfundime dhe rekomandime

PËRFUNDIME

MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

Liria e medias dhe siguria e gazetarëve në Shqipëri vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha që meritojnë vëmendje të posaçme, angazhim të të gjithë aktorëve dhe ndërhyrje strategjike. Pavarësisht garancive që jep Kushtetuta për lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes, zbatimi në praktikë i këtyre të drejtave pengohet nga problemet strukturore, si përqendrimi i pronësisë së mediave dhe ndikimi i interesave të fuqishme politike dhe ekonomike bashkë me problemet me shtetin e së drejtës. Këta faktorë kufizojnë diversitetin e zërave dhe integritetin e informacionit në sektorin e mediave, dëmtojnë transparencën dhe kontribuojnë në rënien e besimit të publikut. Kuadri ligjor, edhe pse ofron një farë mbrojtjeje, ka ende në fuqi kriminalizimin e shpifjes dhe i mungojnë garancitë e qarta ndaj Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPPs). Për më tepër, rritja e kontrollit mbi informacionin publik nga institucionet e qeverisë, shoqëruar me fushata disinformuese nga forca të ndryshme politike dhe ekonomike dhe një rënie në integritetin e informacionit, përkeqëson vështirësitë me të cilat përballen gazetarët profesionistë, të pavarur, dhe me misione, veçanërisht ata të angazhuar në gazetari investigative.

POZICIONI I GAZETARËVE NË REDAKSITË E LAJMEVE

Kushtet e punës së gazetarëve në Shqipëri kanë nevojë për shumë përmirësim me qëllim që të mbështetet integriteti dhe pavarësia e tyre profesionale. Shumë gazetarë përballen me pasiguri ekonomike, me paga të vonuara, mbrojtje të pamjaftueshme sociale dhe mungesë të kontratave të rregullta të punës. Këto sfida bëhen edhe më të rënda nga përqendrimi i pronësisë së medias, ku pavarësia editoriale shpesh rrezikohet për shkak të ndërthurjes së interesave të pronarëve të

mediave me ato të figurave politike dhe aktorëve ekonomikë. Një mjedis i tillë nxit kulturën e autocensurës, duke qenë se gazetarëve u bëhet presion për të harmonizuar raportimin e tyre me interesat e pronarëve të medias, duke çuar në një rënie të cilësisë së përgjithshme të përmbajtjes së raportimit. Për më tepër, mungesa e mbrojtjes së konsoliduar në punë, përfshirë përfaqësimin e sindikatave dhe negociatat kolektive, i lë gazetarët të pambrojtur ndaj shfrytëzimit dhe hakmarrjes. Këto probleme janë veçanërisht të theksuara për gratë gazetare dhe për ata gazetarë që punojnë në mediat lokale ose të pavarura, të cilat përballen edhe me pengesa të tjera, si ngacmimi dhe diskriminimi me bazë gjinore.

SIGURIA E GAZETARËVE

Siguria e gazetarëve mbetet mjaft shqetësuese në Shqipëri. Edhe pse sulmet fizike ndaj tyre janë relativisht të rralla, presionet e vazhdueshme, kërcënimet dhe ngacmimet online me të cilat përballen ata krijojnë një mjedis që mund të dëmtojë aftësinë e tyre për të punuar lirshëm. Institucioneve të zbatimit të ligjit, ndonëse përgjithësisht të përgjegjshëm, shpesh u mungojnë njohuritë e specializuara, burimet dhe protokollet e nevojshme për të hetuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, të shpejtë dhe transparente kërcënimet ndaj gazetarëve. Kjo situatë ndërlikohet më tej nga mungesa e mbrojtjes së posaçme ligjore për gazetarët, veçanërisht në lidhje me ngacmimet online, gjë që i lë ata të pambrojtur ndaj kërcënimeve dixhitale. Është shqetësuese mungesa e një sistemi që u bën të mundur institucioneve të mbledhin, përpunojnë dhe kategorizojnë të dhënat për rastet që kanë të bëjnë me shkeljen e sigurisë së gazetarëve. Ritmi i ngadaltë i hetimeve dhe mungesa e transparencës në procesin gjyqësor kontribuojnë në ndjenjën e pandëshkueshmërisë për ata që kryejnë krime kundër profesionistëve të medias.

PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME

Mjedisi i përgjithshëm për gazetarinë e pavarur dhe profesionale në Shqipëri është aktualisht nën trysni të konsiderueshme për shkak të një kombinimi problemesh strukturore. Ndërthurja e interesave politike, ekonomike dhe mediatike, së bashku me përqendrimin e pronësisë së medias dhe transparencën e kufizuar, kanë krijuar një atmosferë ku gazetaria e pavarur dhe me cilësi të lartë është gjithnjë e më e vështirë për t'u ruajtur. Këto sfida përkeqësohen më tej nga mbrojtja e pamjaftueshme ligjore, kushtet e këqija të punës dhe kërcënimet e vazhdueshme ndaj sigurisë së gazetarëve. Për të nxitur një mjedis më të favorshëm për gazetarinë, reformat gjithëpërfshirëse që të trajtojnë këto probleme themelore janë nevojë më se urgjente. Kjo përfshin forcimin e mbrojtjes ligjore për gazetarët, përmirësimin e kushteve të tyre të punës dhe rritjen e kapaciteteve të institucioneve shtetërore për të mbrojtur sigurinë e tyre.

REKOMANDIME

DIMENSIONI A: MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

- Dekriminalizimi i shpifjes: Të dekriminalizohet tërësisht shpifja me qëllim mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare, duke ulur kështu rrezikun e kërcënimit ligjor ndaj gazetarëve.
- Legjislacioni Anti-SLAPP: Të hartohet dhe zbatohet legjislacioni për mbrojtjen në mënyrë të veçantë të gazetarëve nga paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPPs), në përputhje me direktivën anti-SLAPP të BE-së të miratuar së fundmi.
- Transparencë për pronësinë dhe financimin e mediave: Të forcohen ligjet për të siguruar transparencë të plotë të pronësisë së mediave dhe burimeve të financimit, me qëllim shmangien e konflikteve të interesit dhe sigurimin e pavarësisë së mediave.
- Mbrojtja e burimeve të gazetarëve: Të punohet për zbatimin e rreptë të mbrojtjes ligjore të konfidencialitetit dhe burimeve të gazetarëve me qëllim mbrojtjen e gazetarisë investigative.
- Ndryshimi i Kodit Penal: Të rishikohet Kodi Penal për të përfshirë mbrojtje të posaçme ligjore për gazetarët që sulmohen ose kërcënohen për shkak të detyrës.
- Trajnimi i organeve ligjzbatuese: Të organizohen trajnime të rregullta për institucionet e zbatimit të ligjit lidhur me trajtimin e rasteve të shantazhimit të mediave dhe sulmeve ndaj gazetarëve, duke siguruar që këto institucione të kenë burimet e nevojshme për kryerjen e hetimeve të plota dhe të paanshme.
- Ndryshimi i ligjit për mediat audiovizive: Të ndryshohet ligji për të përcaktuar kritere të qarta, transparente dhe të bazuara në merita për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të AMA-s dhe Këshillit Drejtues të RTSH-së, duke u siguruar që procesi të jetë plotësisht i pavarur nga ndikimi politik dhe i lirë nga formulat partiake. Në ligj duhet të përfshihen mekanizma për mbrojtjen e autonomisë së bordit, si përfshirja e ekspertëve të pavarur të mediave dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në procesin e përzgjedhjes.

DIMENSION B: KUSHTET E PUNËS SË GAZETARËVE DHE PAVARËSIA EDITORIALE

- Zbatimi i të drejtave të punës: Të forcohen kapacitetet dhe pavarësia e Inspektoratit të Punës lidhur me inspektimet e rregullta efektive të të drejtave të punës në sektorin e medias. Të sigurohet zbatimi i rreptë i Kodit të Punës, duke garantuar pagesat në kohë, sigurimet shoqërore dhe stabilitetin e punës për gazetarët, duke promovuar krijimin e sindikatave dhe mekanizmave të negociimeve kolektive.

- Forcimi i transmetuesit të shërbimit publik: Të rritet pavarësia e transmetuesit të shërbimit publik për të siguruar raportim të paanshëm të lajmeve, pa ndikime politike.
- Promovimi i barazisë gjinore: Të mbështetet dhe nxitet barazia gjinore në redaksi, duke promovuar diversitetin dhe mundësitë e barabarta për të gjithë gazetarët dhe gazetaret.
- Stimulimi i gazetarisë cilësore: Të nxitet gazetaria investigative duke ofruar mbështetje publike për rolin e saj në kërkesën e llogarisë ndaj pushtetit dhe promovimin e transparencës.

DIMENSION C: SIGURIA E GAZETARËVE

- Zero tolerancë për sulmet: Të miratohet një politikë e tolerancës zero ndaj frikësimit, kërcënimit dhe sulmeve kundër gazetarëve, duke siguruar që incidente të tilla të hetohen tërësisht, në mënyrë efektive dhe të menjëhershme, si dhe të dënohen publikisht.
- Mekanizmat e specializuar të mbrojtjes: Të krijohen mekanizma të veçantë të mbrojtjes për gazetarët e kërcënuar, përfshirë këtu mundësi për siguri në zhvendosjen dhe rivendosjen e tyre dhe akses në ndihmë juridike falas.
- Masat e sigurisë dixhitale: Të trajtohen problematikat e sigurisë dixhitale duke rritur kapacitetet e institucioneve publike për të adresuar ngacmimet online dhe kërcënimet kibernetike kundër gazetarëve.
- Mbledhja dhe publikimi i të dhënave: Të krijohen mekanizma të besueshëm brenda institucioneve përkatëse për të mbledhur dhe publikuar rregullisht të dhëna për sigurinë e gazetarëve, kushtet e punës dhe problemet përkatëse.
- Personat e Kontaktit të Prokurorisë dhe Policisë, mbështetja, monitorimi dhe bashkëpunimi: Pasi caktimit të personave të kontaktit në Polici dhe Prokurori për trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve, është me rëndësi të ofrohet mbështetje e vazhdueshme dhe të sigurohet monitorim i pandërprerë. Kjo duhet të shoqërohet me inkurajimin e bashkëpunimit të ngushtë me shoqatat e gazetarëve dhe organizatat e lirisë së medias për të rritur efektivitetin e këtyre kontakteve në mbrojtjen e gazetarëve.

D. SHOQATAT E GAZETARËVE DHE SOLIDARITETI

- Mbështetje për verifikimin e fakteve dhe gazetarinë hulumtuese: Të krijohen dhe forcohen platforma për shoqatat e gazetarëve, mediat dhe organizatat mbështetëse për të bashkëpunuar në verifikimin e fakteve, raportimin investigativ dhe mbrojtjen e gazetarëve të kërcënuar.
- Krijimi i mekanizmave të vetërregullimit: Të hartohen dhe zbatohen mekanizma të vetërregullimit brenda

sektorit të medias për të mbështetur standardet etike dhe mbrojtur të drejtat e gazetarëve.

- Ofrimi i rritjes të kapaciteteve dhe solidaritetit: Të rriten kapacitetet, burimet dhe solidariteti i shoqatave të gazetarëve për të mbështetur anëtarët që përballen me sfida ligjore, kërcënime ose sulme.


IV

Treguesi i sigurisë së gazetarëve në Shqipëri – 2023

Në këtë pjesë të raportit jepet një paraqitje grafike e Treguesit të Sigurisë së Gazetarëve për vitin 2023, krahasuar me vitin e kaluar 2022. Për secilin nga katër dimensionet dhe për të 19 treguesit jepet një shpjegim i shkurtër i ndryshimeve kryesore që ndodhën në vitin 2023.

Në pjesën përshkuese të raportit ofrohet një shpjegim më i gjerë i të dhënave dhe ndryshimeve që kanë ndodhur për secilin tregues të veçantë në këtë indeks.

| Treguesi në Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve | Raporti përshkues |
|---|----------------------|
| I. Mjedisi ligjor dhe organizativ | |
| Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimin e tyre nuk prodhojnë efekte frenuese për gazetarët dhe mediat. | A.6 |
| Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve garantohet me ligj dhe respektohet nga autoritetet. | A.8 |
| Ligjet e tjera zbatohen me objektivitet dhe u bëjnë të mundur gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias të punojnë lirisht dhe të sigurt. | A.7 |
| Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, të anëtarësohen e të marrin pjesë në shoqatat e tyre. | A.9 |
| Vendi i punës i gazetarëve është i garantuar dhe i mbrojtur në mjedisin e punës | B.1 |
| II. Parandalimi i dhur | |
| Gazetarët dhe punonjësit e medias kanë akses te masat e menjëhershme dhe efektive mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar. | C.1 |
| Gazetarët dhe punonjësit e tjerë të medias (jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë akses te mekanizma të posaçëm. | C.2 |
| Gazetare gra kanë akses te masat ligjore dhe mekanizmat e mbështetjes kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore. | C.3 |
| Është krijuar praktika e rregullt e dënimit publikisht të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave. | C.4 |
| Organet e policisë janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve. | C.5 |
| III. Procesi i rregullt | |
| Njësitë dhe/ose oficerët që mbulojnë hetimet e specializuara janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve. | C.6 |
| Hetimet për sulme të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë efikase (të pavarur, të plotë dhe të menjëhershme). | C.7 |
| Gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave mbrohen me efikasitetet nga format e ndryshme të ngacmimeve online. | C.8 |
| Hetimet e të gjitha formave të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente. | C.9 |
| Autoritetet shtetërore krijojnë sisteme cilësore të mbledhjes së statistikave për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë. | C.10 |
| IV. Siguria aktuale | |
| Kërcënime dhe ngacmime që nuk lidhen me sigurinë fizike | C.11 |
| Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve | C.12 |
| Sulmet aktuale | C.13 |
| Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve | C.14 |



Treguesi i sigurisë së gazetarëve në Shqipëri - 2023

| | 2022 | 2023 | | Zhvillimet kryesore të reja në secilin dimension |
|--|-------------|-------------|----------|---|
| I. Mjedisi ligjor dhe organizativ | 3.27 | 3.13 | ↓ | Në vitin 2023, në Shqipëri u rrit numri i padive kundër gazetarëve, ku shumë prej këtyre padive u konsideruan si SLAPP dhe synonin të mbysnin raportimin investigativ. Nga një rast serioz dolën në pah shqetësime për konfidencialitetin e burimit kur autoritetet konfiskuan materialet personale dhe profesionale të një gazetari. Kushtet e punës për gazetarët mbeten ende të pasigurta. |
| II. Parandalimi i duhur | 2.95 | 2.95 | – | Në vitin 2023, gazetarëve në Shqipëri u mungonin masat efikase mbrojtëse; ata nuk kishin asnjë ndihmë juridike të përshtatur për ta apo mekanizma të posaçëm sigurie. Reagimi i shtetit ndaj kërcënimeve, veçanërisht ngacmimeve online, mbeti i ngadaltë dhe i pamjaftueshëm, duke i lënë gazetarët të pambrojtur. Gratë gazetare u përballën me mbrojtje të kufizuar të posaçme gjinore dhe dënimi publik i sulmeve bëhej me hope. |
| III. Procesi i rregullt | 2.60 | 2.58 | ↓ | Në vitin 2023, në Shqipëri nuk pati asnjë përmirësim lidhur me krijimin e njësive të specializuara apo protokolleve për hetimin e sulmeve ndaj gazetarëve. Hetimet për sulme të rënda fizike dhe ngacmime në internet mbetën të pamjaftueshme, duke çuar në një ndjenjë pandëshkueshmërie. Mungon një sistem gjithëpërfshirës për mbledhjen e të dhënave që lidhen me sulmet ndaj gazetarëve. |
| IV. Siguria aktuale | 2.78 | 2.75 | ↓ | Në vitin 2023, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt regjistroi 24 raste. U regjistruan pesë raste kërcënimesh dhe ngacmimesh jo-fizike ndaj gazetarëve, shpesh të kryera nga zyrtarë publikë gjë që përbën shqetësim për sigurinë. U raportuan edhe dy kërcënime për sigurinë fizike të gazetarëve dhe nëntë sulme aktuale, përfshirë edhe sulme fizike ndaj gazetarëve gjatë punës. Përveç kësaj, ka pasur nëntë raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj mediave, përfshirë këtu një sulm me armë me fund tragjik në një televizion kombëtar. |
| Treguesi i sigurisë së gazetarëve | 2.84 | 2.80 | ↓ | |

Mjedisi ligjor dhe organizativ



TREGUESI 1.1

— DISPOZITAT LIGJORE NË LIDHJE ME SHPIFJEN DHE ZBATIMI E TYRE NUK PRODHOJNË EFEKTE FRENUESE PËR GAZETARËT DHE MEDIAT.

Pikët për 2022: 3.08 / Pikët për 2023: 2.89

Shqipëria e kategorizon shpifjen si vepër penale, gjë që është në kundërshtim me praktikën më të mira ndërkombëtare. Edhe pse dënimi me heqje lirie për shpifje u hoq në vitin 2012, gjambat e rënda janë ende në problem dhe mund të pengojnë lirinë e shprehjes si dhe të çojnë në autocensurë mes gazetarëve. Kuadri ligjor në fuqi nuk përputhet plotësisht me standardet e Këshillit të Evropës dhe të BE-së. Organizatat e shoqërisë civile kanë kërkuar dekriminalizimin e plotë të shpifjes, shoqëruar me uljen e gjobave përkatëse dhe përcaktimin e një përkufizimi ligjor për SLAPP-in. Të dhënat e vitit 2023 nxjerrin në pah rritje të padive për shpifje kundër gazetarëve, vonesa në përpunimin e çështjeve dhe mungesën e transparencës për rezultatet e padive gjyqësore, të cilat përkeqësojnë efektet frenuese mbi lirinë e medias.

TREGUESI 1.2

— KONFIDENCIALITETI I BURIMEVE TË GAZETARËVE GARANTOHET ME LIGJ DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET.

Pikët për 2022: 4.14 / Pikët për 2023: 3.79

Në Shqipëri, konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve mbrohet me ligj. Gazetarët në përgjithësi përjashtohen nga detyrimi për të treguar burimin e informacionit, përveç rastit kur urdhërohen nga gjykata në procedurë penale ku informacioni konsiderohet vendimtar për të provuar një vepër penale. Megjithatë, pavarësisht këtyre masave mbrojtëse të përcaktuara me ligj, në vitin 2023 pati një rast ku një mbrojtje e tillë iu mohua gazetarit Elton Qyno, të cilit iu bë presion gjatë një hetimi nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) për të treguar burimin e informacionit, gjë që ngritit shqetësime për respektimin në praktikë të konfidencialitetit të burimit.

TREGUESI 1.3

— LIGJET E TJERA ZBATOHEN ME OBJEKTIVITET DHE U BËJNË TË MUNDUR GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAS TË PUNOJNË LIRISHT DHE TË SIGURT.

Pikët për 2022: 3.11 / Pikët për 2023: 3.10

Kuadri ligjor në Shqipëri i lejon gazetarët të punojnë lirisht, por zbatimi arbitrar i ligjeve, të tilla si ato për shpifjen, gjuhën e urrejtjes dhe mbrojtjen e të dhënave, mund t'i frikësojnë gazetarët dhe të kufizojnë lirinë e medias. Mungesa e masave të qarta mbrojtëse kundër Padive Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike i bën edhe më serioze këto sfida. Për më tepër, gazetarët nuk përfitojnë nga ndihma juridike e garantuar nga shteti, duke ua bërë të vështirë atyre mbrojtjen kundër ngacmimeve ligjore. Në vitin 2023, pati një rast të një gazetari ndaj të cilit u bënë shumë padi për shpifje nga një person me lidhje politike.

TREGUESI 1.4

— GAZETARËT JANË TË LIRË TË USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË KRIJOJNË, TË ANËTARËSOHEN E TË MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE.

Pikët për 2022: 3.73 / Pikët për 2023: 3.73

Në Shqipëri gazetarët janë ligjërisht të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre pa pasur nevojë për licencë shtetërore dhe në vitin 2023 nuk ka pasur asnjë përpjekje për të vendosur kërkesa të tilla. Edhe pse gazetarët kanë të drejtë të krijojnë, të anëtarësohen dhe të marrin pjesë në shoqata profesionale, problemet mbeten gjithsesi, përfshirë këtu kufizimet në ndjekjen e aktiviteteve të caktuara si dhe praktikën e përbashkët të politikanëve dhe zyrtarëve të nivelit të lartë lidhur me shpërndarjen e materialeve mediatike të përgatitur paraprakisht dhe shmangien e ndërveprimit të drejtpërdrejtë me median. Përveç kësaj, gazetarët dhe reporterët e pavarur shpesh përballen me vështirësi për t'u njohur dhe për t'u akredituar si të tillë. Pavarësisht këtyre problemeve, nuk ka presion të konsiderueshëm nga autoritetet publike për të penguar gazetarët të anëtarësohen në shoqata, ndonëse sindikatat praktikisht nuk ekzistojnë, duke i lënë gazetarët pa një përfaqësim dhe mbështetje të konsoliduar kolektive.

TREGUESI 1.5

— VENDI I PUNËS I GAZETARËVE ËSHTË I GARANTUAR DHE I MBROJTUR NË MJEDISIN E PUNËS

Pikët për 2022: 2.27 / Pikët për 2023: 2.11

Edhe pse shumica e gazetarëve në Shqipëri kanë kontrata të rregullta pune, vendi i tyre i punës shpesh nuk është i qëndrueshëm ose nuk mbrohet siç duhet. Në vitin 2023, ashtu si në vitet e mëparshme, problematikat e zakonshme ishin vonesat e pagave, mungesa e përfitimeve të sigurimeve shoqërore, orët e gjata të punës dhe marrëveshjet informale të punësimit, veçanërisht për korrespondentët në rrethe dhe gazetarët online. Për më tepër, shumë gazetarë përballen me kushte të pasigurta pune pa përfaqësim sindikal ose marrëveshje kolektive për mbrojtjen e të drejtave të tyre në punë. Ankesat për largime të padrejta nga puna dhe shkelje të tjera lidhur me vendin e punës ishin të shpeshta në vitin 2023, por frika nga hakmarrja dhe burimet e kufizuara bënë që shumë gazetarë të mos kërkonin dëmshpërblim. Në përgjithësi, mbrojtja e vendit të punës të gazetarëve në Shqipëri mbetet e pamjaftueshme.



Parandalimi i duhur

Gazetarët dhe aktorët e medias kanë akses te masat e menjëhershme dhe efektive mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar

2.80

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias (jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë akses te mekanizmat specifikë...

2.78

Gazetare gra kanë akses te masat ligjore dhe mekanizmat e mbështetjes kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

3.49

Është krijuar praktika e rregullt e dënimit publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

2.59

Organet e policisë janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve

3.09

1.00 Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e menjëhershme të gazetarëve në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve nuk ekzistojnë. Zyrtarët inkurajojnë sulmet ndaj gazetarëve dhe policët i trajtojnë gazetarët jashtëzakonisht ashpër.

2.00

3.00

4.00

5.00

6.00

7.00



Janë krijuar të gjithë mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e menjëhershme të gazetarëve në rast sulmesh. Zyrtarët dekurajojnë qartë dhe sistematikisht sulmet ndaj gazetarëve dhe organet e policisë i trajtojnë me respekt gazetarët.

TREGUESI 2.1

— GAZETARËT DHE PUNONJËSIT E MEDIAS KANË AKSES TE MASAT E MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE MBROJTËSE KUR NDJEHEN TË KËRCËNUAR.

Pikët për 2022: 2.80 / Pikët për 2023: 2.80

Në Shqipëri mungojnë mekanizmat e posaçëm të krijuar për të ofruar masa mbrojtëse të menjëhershme dhe efikase për gazetarët dhe punonjësit e medias kur përballen me kërcënime. Edhe pse ekziston një numër i përgjithshëm emergjence, ai nuk është i përshtatur për raportimin e kërcënimeve ndaj gazetarëve. Sipas masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, do të caktohen persona të posaçëm kontakti në Polici dhe Prokurori për gazetarët. Edhe ndihma juridike është e kufizuar, duke pasur parasysh se gazetarët nuk përfitojnë në mënyrë të veçantë nga shërbimet ligjore të ofruara nga shteti. Janë disa OJQ që ofrojnë mbështetje ligjore, por këto përpjekje nuk janë të qëndrueshme apo të mjaftueshme. Në përgjithësi, në vitin 2023, reagimi i shtetit ndaj kërcënimeve ndaj gazetarëve ishte shpesh i ngadaltë dhe joefikas, veçanërisht lidhur me ngacmimin online dhe gjuhën e urrejtjes, duke i lënë gazetarët të pambrojtur apo me mbrojtje të pamjaftueshme.

TREGUESI 2.2

— GAZETARËT DHE PUNONJËSIT E TJERË TË MEDIAS (JETA OSE INTEGRITETI FIZIK I TË CILËVE JANË NË RREZIK REAL DHE TË MENJËHERSHËM) KANË AKSES TE MEKANIZMA TË POSAÇËM.

Pikët për 2022: 2.78 / Pikët për 2023: 2.78

Në Shqipëri nuk ka mekanizma mbrojtës të dedikuar posaçërisht për gazetarët dhe punonjësit e medias që përballen me kërcënime reale dhe të menjëhershme për jetën apo integritetin fizik të tyre. Mekanizmat ekzistues të mbrojtjes së viktimave nuk janë të përshtatura për të trajtuar rreziqet unike me të cilat përballen gazetarët. Edhe pse disa organizata të shoqërisë civile ofrojnë ndihmë dhe mbështetje ligjore, këto nisma nuk duhet të konsiderohen si zëvendësim për mekanizmat gjithëpërfshirëse të sigurisë me mbështetje shtetërore. Mungesa e vlerësimeve sistematike të rrezikut dhe e protokolleve të specializuara të mbrojtjes i lë gazetarët pa mbrojtje, me opsione të papërshtatshme për të garantuar sigurinë e tyre në situata me rrezik të madh.

TREGUESI 2.3

— GAZETARE GRA KANË AKSES TE MASAT LIGJORE DHE MEKANIZMAT E MBËSHTETJES KUR PËRBALLEN ME KËRCËNIME, NGACMIME DHE DHUNË ME BAZË GJINORE.

Pikët për 2022: 3.49 / Pikët për 2023: 3.49

Kuadri ligjor në Shqipëri, përfshirë këtu edhe nga ratifikimi i Konventës së Stambollit, ofron njëfarë mbrojtjeje kundër dhunës me bazë gjinore, por nevojat specifike të grave gazetare nuk trajtohen në mënyrë të përshtatshme. Masat

ligjore dhe mekanizmat mbështetës fokusohen kryesisht në dhunën në familje, ndërkohë që burimet e përshtatura për gratë gazetare që përballen me ngacmimin në vendin e punës ose dhunën online janë të kufizuara. Shumë gra gazetare hezitojnë t'i denoncojnë incidentet për shkak të frikës nga hakmarrja dhe mungesës së besimit të përgjigja institucionale. Mungesa e sistemeve mbështetëse gjithëpërfshirëse me ndjeshmëri gjinore e përkeqëson më tej cenueshmërinë e tyre ndaj kërcënimeve dhe ngacmimeve.

TREGUESI 2.4

— **ËSHTË KRIJUAR PRAKTIKA E RREGULLT E DËNIMIT PUBLIKISHT TË KËRCËNIMEVE DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE.**

Pikët për 2022: 2.73 / Pikët për 2023: 2.59

Praktika e dënimit publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në Shqipëri është me hope dhe shpesh e ndikuar nga interesat politike. Edhe pse disa zyrtarë publikë herë pas here i dënojnë publikisht incidente të tilla, këto deklarata janë zakonisht sipërfaqësore dhe u mungon vazhdimësia deri në fund. Politizimi i problemeve me lirinë e medias çon në reagime të pabarabarta, ku partitë opozitare kanë më shumë gjasa të dënojnë sulmet nëse përbëjnë argument kundër qeverisë, ndërsa zyrtarët e qeverisë shpesh i minimizojnë ose i injorojnë ato. Kjo qasje e paqëndrueshme kontribuon në një klimë pandëshkueshmërie, ku kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve nuk trajtohen apo dënohen në mënyrën e duhur, duke minuar lirinë dhe sigurinë e shtypit.

TREGUESI 2.5

— **ORGANET E POLICISË JANË TË NDJESHME NDAJ ÇËSHTJES SË MBROJTJES SË GAZETARËVE.**

Pikët për 2022: 2.94 / Pikët për 2023: 3.09

Në Shqipëri janë ndërmarrë disa nisma për ngritjen e kapaciteteve për oficerët e policisë lidhur me sigurinë e gazetarëve dhe të drejtat e njeriut, por këto përpjekje mbeten të pamjaftueshme. Organet e policisë nuk kanë të miratuar protokolle apo udhëzime të veçanta për të parandaluar ngacmimet, kërcënimet apo sulmet fizike ndaj gazetarëve. Në përgjithësi policia reagon ndaj incidenteve që kanë të bëjnë me gazetarë, por veprimet e saj janë shpesh të papërshtatshme, veçanërisht në trajtimin e kërcënimeve në internet dhe gjuhës së urrejtjes. Bashkëpunimi mes organeve të policisë dhe shoqatave të gazetarëve është i kufizuar. Në vitin 2023 nuk u regjistrua asnjë rast i ndalimeve të pabazë të gazetarëve.



Procesi i rregullt

Njësitë dhe/ose oficerët e investigimit të specializuara janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

2.93

Hetimet për sulme të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë efektive (të pavarur, të plotë dhe të menjëhershme)

2.60

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen me efikasitetet nga format e ndryshme të ngacmimeve online

2.53

Hetimet e të gjitha formave të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente

2.55

Autoritetet shtetërore krijojnë sisteme cilësore të mbledhjes së statistikave për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë

2.28

1.00

Institucionet nuk hetojnë dhe nuk dënojnë sulmet ndaj gazetarëve, përfshirë ngacmimet në internet, kërcënimet për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve dhe mediave.

2.00

3.00

4.00

5.00

6.00

7.00



Institucionet janë plotësisht efektive dhe transparente në hetimin dhe dënimin e sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë këtu ngacmimet në internet, kërcënimet për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve dhe mediave.

TREGUESI 3.1

— NJËSITË DHE/OSE OFICERËT QË MBULOJNË HETIMET E SPECIALIZUARA JANË TË PAJISUR ME EKSPERTIZËN PËRKATËSE PËR HETIMIN E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE.

Pikët për 2022: 2.96 / Pikët për 2023: 2.93

Shqipërisë i mungojnë njësitë e specializuara të hetimit apo punonjësit e trajnuar posaçërisht për të trajtuar rastet e dhunës dhe sulmeve kundër gazetarëve. Edhe pse këto raste trajtohen nga organet e përgjithshme të zbatimit të ligjit, mungesa e ekspertizës së specializuar shpesh rezulton në hetime me mangësi dhe vonesa për trajtimin e kërcënimeve. Mangësitë në njohuri dhe mungesa e trajnimeve të specializuara pengojnë mbrojtjen efektive të gazetarëve dhe nxisin klimën e pandëshkueshmërisë për ata që ushtrojnë dhunë ndaj profesionistëve të medias.

TREGUESI 3.2

— HETIMET PËR SULME TË RËNDA FIZIKE NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN NË MËNYRË EFIKASE (TË PAVARUR, TË PLOTË DHE TË MENJËHERSHME).

Pikët për 2022: 2.61 / Pikët për 2023: 2.60

Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve në Shqipëri shpesh nuk janë as të plota dhe as të shpejta. Ka vonesa të shpeshta dhe hetimet ndonjëherë kryhen pa pavarësinë e nevojshme, duke ngritur shqetësime për paragjykimet e mundshme ose mungesën e paanshmërisë. Mungesa e efikasitetit të këtyre hetimeve kontribuon në një ndjenjë pandëshkueshmërie, pasi autorët jo gjithmonë përgjigjen para ligjit, gjë që minon sigurinë e gazetarëve dhe sektorin e mediave në përgjithësi. Sulmi i armatosur me një viktimë ndaj një televizioni kombëtar në Shqipëri ka mbetur ende i pazbardhur.

TREGUESI 3.3

— GAZETARËT DHE PUNONJËSIT E TJERË TË MEDIAVE MBROHEN ME EFIKASITETET NGA FORMAT E NDRYSHME TË NGACMIMEVE ONLINE.

Pikët për 2022: 2.58 / Pikët për 2023: 2.53

Gazetarët dhe punonjësit e medias hasin në vështirësi të mëdha për të siguruar mbrojtje nga ngacmimet online. Kornizat ligjore dhe institucionale nuk janë të përshtatshme për të trajtuar numrin në rritje të kërcënimeve, ngacmimeve dhe abuzimeve në internet objekt i të cilëve janë gazetarët. Janë disa organizata të shoqërisë civile që ofrojnë mbështetje, ndërkohë që shtetit i mungojnë mekanizmat dhe burimet e duhura për të ofruar mbrojtje në kohë dhe me efikasitet. Ky boshllëk i lë gazetarët të pambrojtur ndaj ngacmimeve në internet, me mundësi të kufizuara për të kërkuar drejtësi ose mbrojtje nga kërcënimet e vazhdueshme dixhitale.

TREGUESI 3.4

— HETIMET E TË GJITHA FORMAVE TË SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN NË MËNYRË TRANSPARENTE.

Pikët për 2022: 2.57 / Pikët për 2023: 2.55

Shpesh hetimet për sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve në Shqipëri kryhen me shumë pak transparencë. Mungon informimi i vazhdueshëm i publikut për rezultatet e këtyre hetimeve dhe hollësitë për këto të fundit shpesh mbulohen nën petkun e sekretit hetimor. Kjo paqartësi minon besimin e publikut tek procesi dhe kontribuon në rritjen e perceptimit të pandëshkueshmërisë, pasi publiku e ka të vështirë të vlerësojë nëse drejtësia po vihet në vend. Mungesa e transparencës në këto hetime përkeqëson më tej cënueshmërinë e gazetarëve dhe punonjësve të medias ndaj dhunës dhe kërcënimit.

TREGUESI 3.5


— AUTORITETET SHTETËRORE KRIJOJNË SISTEME CILËSORE TË MBLLEDHJES SË STATISTIKAVE PËR T'I DHËNË FUND PANDËSHKUESHMËRISË.

Pikët për 2022: 2.28 / Pikët për 2023: 2.28

Ka mangësi të mëdha në mbledhjen dhe menaxhimin e statistikave cilësore lidhur me sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve në Shqipëri. Autoriteteve shtetërore u mungon një sistem gjithëpërfshirës për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për incidente të tilla, gjë që pengon përpjekjet për të trajtuar në mënyrë efektive pandëshkueshmërinë. Pa të dhëna statistikore të besueshme dhe transparente, është e vështirë të gjurmohet shpeshësia, natyra dhe rezultatet e sulmeve ndaj gazetarëve, gjë që dobëson aftësinë për të zbatuar politika dhe masa të efektshme për mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve të medias dhe vënien para drejtësisë të autorëve. Në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës jepen dispozita për ngritjen e mekanizmit të mbledhjes së të dhënave nga Policia dhe Prokuroria.

IV

Siguria aktuale



TREGUESI 4.1

— KËRCËNIME DHE NGACMIME QË NUK LIDHEN ME SIGURINË FIZIKE

Pikët për 2022: 3.37 / Pikët për 2023: 3.05

Kërcënimet jofizike dhe ngacmimet e gazetarëve janë një problem i vazhdueshëm në Shqipëri. Në vitin 2023, u raportuan pesë raste të kërcënimeve jofizike, që kishin të bënin me gazetarë dhe gazetare. Rastet ilustron tendencën shqetësuese të zyrtarëve publikë që angazhohen ose nxisin ngacmime ndaj gazetarëve në përgjithësi, gjë që përkeqëson mjedisin tashmë të brishtë për profesionistët e pavarur të medias.

TREGUESI 4.2

— KËRCËNIMET KUNDËR JETËS DHE SIGURISË FIZIKE TË GAZETARËVE

Pikët për 2022: 4.30 / Pikët për 2023: 4.18

Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve nuk janë sistematike në Shqipëri. Megjithatë, gjatë vitit 2023 u raportuan publikisht dy raste.

TREGUESI 4.3

— SULMET AKTUALE

Pikët për 2022: 3.37 / Pikët për 2023: 3.37

Në vitin 2023, në Shqipëri u raportuan nëntë raste të sulmeve aktuale ndaj gazetarëve, që kishin të bënin me 12 burra dhe 4 gra gazetare. Këto sulme varionin nga sulmet fizike deri te kërcënimet në kohën e raportimit. Raste të rënda ishte ai i sulmit fizik ndaj gazetarit Gjergj Zefi, i cili u godit me sende të mprehta nga persona të paidentifikuar, si dhe sulmi i dhunshëm ndaj gazetarit Elvis Hila dhe bashkëshortes së tij në Lezhë, pas raportimit të një seance gjyqësore.

TREGUESI 4.4

— KËRCËNIME DHE SULME NDAJ MEDIAVE DHE SHOQATAVE TË GAZETARËVE

Pikët për 2022: 3.84 / Pikët për 2023: 3.59

Në vitin 2023, në Shqipëri pati një rritje të kërcënimeve dhe sulmeve kundër mediave dhe shoqatave të gazetarëve. Janë regjistruar nëntë raste, gjë që përbën një tendencë shqetësuese. Ndër incidentet më të rënda ishte rasti me të shtënat në televizionin kombëtar Top Channel, që rezultuan në vdekjen e një roje sigurie si dhe sulmet kibernetike kundër disa mediave në vend.

Titulli në origjinal
Shqipëria – Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave
dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve 2023

Botues
Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (Safe Journalists Network)
Tiranë, 2024

Autor
Blerjana Bino

Redaktorë
Kristina Voko, Media Expert
Erida Skëndaj, Legal Expert

Redaktimi letrar dhe përkthimi
Durim Tabaku

Fotografia e ballinës
Andrija Vukelić

Dizajni
comma.rs



Ky publikim u bë i mundur me mbështetjen
financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja
e tij është përgjegjësi vetëm e autores dhe
nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet
dhe opinionet e Bashkimit Evropian.